



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KRYEMINISTRIA**  
**INSPEKTORATI QENDROR**

Inspektorati Qendror, edhe përgjatë vitit 2021, një vit mjaft i vështirë për Shqipërinë, prej pandemisë globale, ka vijuar sfidën për vendosjen e veprimtarive inspektuese të gjithë Inspektorateve Shtetërore dhe vendore në drejtimin ligjor. Në vitin që lamë pas kjo sfidë ka vijuar pa ndërprerje në përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj.

Inspektorati Qendror, si institucioni nukël, me përgjegjësinë ligjore në përmirësimin të efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në vend, ka udhëhequr Taks-Forcën Anti-Covid, me qëllim garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në njësitë tregtare të lejuara të ushtrojnë aktivitetin për periudhën e epidemisë së shkaktuar nga COVID19.

Me gjithë situatën e krijuar, inspektoratet shtetërore, nën udhëheqjen dhe koordinimin e Inspektoratit Qendror, kanë realizuar objektivin kryesor për kryerjen e veprimtarisë inspektuese online nëpërmjet sistemit elektronik “e-Inspektimi”, me dokumente standarde, listë-verifikimi, nënshkrim elektronik dhe me sistem GPS dhe Regjistrim Video & Audio.

Inspektorati Qendror, nëpërmjet unifikimit të procesit inspektues ka rritur në mënyrë të ndjeshme transparencën e procedurave të inspektimit dhe ka në fokus ngritjen e mëtejshme profesionale të inspektorëve shtetërorë/vendorë, me synim rritjen e mëtejshme të besueshmërisë së publikut ndaj procesit inspektues.

Nisur nga objektivat strategjike të ndërmarra më parë nga Inspektorati Qendror, atë të ofrimit të ndryshimit rrënjësor në veprimtaritë inspektuese në vend, objektivi jonë është avancimi më tej në këtë drejtim duke propozuar ndryshimet në ligjin për inspektimit. Këto ndryshime të domosdoshme janë kërkuar nga të gjitha dhomat e biznesit Vendase e të huaja, si dhe janë pjesë e strategjive të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, e cila ka si qëllim të nxisë masat për të luftuar politizimin dhe korrupsionin, ngritjen e procesit të rekrutimit dhe karrierës profesionale të trupave inspektuese, duke forcuar politikat dhe legjislacionin me qëllim përmbushjen e standardeve për integrimin në BE.

Inspektorati Qendror, është angazhuar me përkushtim për të arritur objektivat në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor në lidhje me misionin në fushën e veprimtarive inspektuese, pasi kemi synuar gjatë punës tonë të rrisim dhe forcojmë besimin e qytetarëve tanë në cilësinë e mallrave dhe shërbimeve, formalizmin e ekonomisë në vend, uljen e barrës administrative, si dhe t’u garantojmë atyre ruajtjen me transparencë dhe përkushtim të burimeve dhe aseteve natyrore të vendit tonë.

Puna jonë për përmirësim të vazhdueshëm në këtë drejtim është, që nëpërmjet inspektimeve të arrijmë të formalizojmë bizneset dhe t'i krijojmë hapësirë konkurrencës së ndershme e cila do të garantojë rritje ekonomike të qëndrueshme në vend, si pjesë e zbatimit të reformës ekonomike e shoqëruar me riorganizimin cilësor të inspektorateve dhe ndryshimin ligjor.

Në emër të stafit, qytetarëve, bizneseve që na kanë besuar si dhe partnerëve ndërkombëtarë, marrim angazhim, se iniciativa për të krijuar një platformë të re me standard bashkëkohor evropian në fushën e inspektimeve, do të jetë sfida dhe qëllimi ynë kryesor, për të përmbushur marrëveshjen e ndërmarrë në Samitin e Londrës, në vitin 2017, të Qeverisë tonë si dhe përmbushjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

## **INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**SHKËLQIM HAJDARI**



## TABELA E PËRMBAJTJES

Mesazhi i Inspektorit të Përgjithshëm.....	1
Legjenda e Institucioneve .....	4
I. Hyrje.....	5
II. Qëllimi.....	8
III. Metodologjia.....	9
IV. Objektivat.....	10
V. Veprimtaria e Inspektoratit Qendror për Vitin 2021.....	11
VI. Raportimi i veprimtarisë së trupave inspektuese sipas ministrive të linjës.....	13
1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave .....	13
2. Ministria e Punëve të Brendshme .....	14
2.1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit .....	14
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë.....	16
3.1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore .....	16
3.2. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut .....	18
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.....	20
4.1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.....	20
4.1.1. Drejtoria e Inspektimit të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve.....	20
4.1.2. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion.....	21
4.1.3. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike.....	21
4.1.4. Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare.....	21
4.1.5. Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit.....	21
4.2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.....	23
4.3. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.....	24
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.....	25
5.1. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.....	25
6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	26
6.1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.....	26
6.2. Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës.....	29
7. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	31
7.1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.....	31
7.2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.....	32
7.3. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.....	34
8. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.....	35
8.1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit.....	35
8.2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit.....	37
VII. Raportimi i Veprimtarisë për Inspektoratet Vendore.....	39
VIII. Raport Monitorimi i Buxhetit për Vitin 2021, Inspektorati Qendror.....	39
IX. Konkluzione.....	41
X. Rekomandime.....	43

## Legjenda e Institucioneve

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBPM	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKSEM	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DINGN	Drejtoria e Inspektimit të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve
DIPIE	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike
DIPNP	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion
DSKIG	Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPI	Drejtoria e Pronësisë Intelektuale
DSHPA	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
DT	Drejtoria Teknike
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IQ	Inspektorati Qendror
ISHMT	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
OMP	Organizata e Menaxhimit të Peshkut
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
ZMR	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

## I. HYRJE

Në kontekstin e përgjithshëm, Inspektorati Qendror, duke vlerësuar se inspektimet janë një prej veprimtarive më të rëndësishme dhe për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore, edhe për vitin 2021 vazhdoi intensifikimin e aktivitetit institucional për bashkërendimin, koordinimin, mbikëqyrjen dhe përmirësimin e procesit inspektues.

Pavarësisht nga vazhdimi i situatës së pandemisë nga COVID-19, e cila tashmë nuk ishte e panjohur, përsëri pati një ndikim në ecurinë e punës për arritjen e objektivave, ku shpesh herë burimet njerëzore duhet të punonin në distancë, online, me orare të reduktuara dhe me koordinim të punës nga shtëpia. Gjithsesi, Inspektorati Qendror mbikëqyri dhe mbështeti veprimtarinë inspektuese të inspektorateve shtetërore dhe vendore, me qëllim përmbushjen e misionit të tij në përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektorati Qendror, si një institucion që udhëheq kryerjen e veprimtarisë inspektuese online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, ka vendosur standarde unifikuese, të cilat përgjatë vitit 2021 gjetën zbatim nga 13 inspektorate shtetërore, ku palët e përfshira në proces janë më pro aktiv dhe me një qasje të ndërsjelltë, duke siguruar inspektime ligjore, në kohë reale, pranë dhe në prani të biznesit, si dhe duke rritur transparencën e procesit inspektues.

Ndërsa 3 trupa të tjera inspektuese si: (i) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit; (ii) Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, vazhdojnë akoma të mos kryejnë inspektime online, konform rregullave të përcaktuara, duke zhvilluar veprimtarinë inspektuese me blloqe, pavarësisht se Inspektorati Qendror ka siguruar infrastrukturën e duhur; (iii) Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, është në proces lidhur me implementimin në sistem të dokumenteve standarde dhe listë-verifikimeve.

Ka vijuar bashkërendimi i trupave inspektuese për AKBPM, AKM, AKU, ISHPSHSH, ISHSH, në kuadër të marrjes së masave për zbatimin e protokolleve të sigurisë dhe në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, sipas urdhrit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 156, datë 10.03.2020.

Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese online të inspektorateve shtetërore dhe trupave të tjera inspektuese, u konstatua se procesi inspektues përgjithësisht kryhej konform ligjit për inspektimin, por me disa mangësi, ku Inspektorati Qendror ka dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre, sipas fushave të inspektimit, që mbulon secili inspektorat shtetëror.

Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore, ku marrëdhënia e punësimit rregullohet sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, ka bërë vlerësimin dhe testimin e aftësive profesionale për 165 inspektorë në kohë prove, nga të cilët: AKU – 76; ISHTI – 6; ISHSH – 83.

Për rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese online, janë trajnuar dhe ritrajnuar 404 inspektorë. (AKU – 62; ISHSH – 85; IKMT – 240 dhe AKBPM – 17).

Përgjatë vitit 2021, për kryerjen e inspektimeve online, janë shpërndarë për inspektoratet shtetërore pajisje tablet dhe paketa portabël si: ISHSH – 53 kite dhe 5 tableta; IKMT – 13 kite dhe 30 tableta; ISHMT – 4 kite dhe Bashkia Lezhë – 2 kite dhe 9 tableta.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2021, ka vazhduar edhe puna rutinë e përditësimit dhe mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të inspektorëve në detyrë për inspektoratet shtetërore dhe për inspektoratet vendore, bazuar kjo në lëvizjet e burimeve njerëzore, sipas kreut IV, të VKM 696/16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”.


Gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, inspektori identifikohet me kartën e inspektorit dhe për vitin 2021 u pajisën me karta inspektori 260 inspektorë.

Në bazë të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është komunikuar me të gjitha bashkitë ku janë përshtatur dokumentet standarde të inspektimit dhe listë verifikimet, për të gjitha fushat e inspektimit që ato mbulojnë në territorin e tyre. Janë trajnuar 40-inspektorë bashkia Lezhë, lidhur me procedurat online të inspektimit dhe plotësimin e dokumentacionin e inspektimit.

Është hartuar edhe paketa e plotë ligjore për amendimin e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore në fushën e inspektimit, të cilat janë dërguar pranë Kryeministrisë.


Gjatë vitit 2021, inspektoratet shtetërore kanë kryer gjithsej 77912 inspektime online nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”, nga të cilat 60991 janë të programuara dhe 16921 janë jashtë programit, sipas paraqitjes grafike sa më poshtë:

Inspektime online nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi” nga Inspektoratet Shtetërore për vitin 2021



Për shkeljet e konstatuara Inspektoratet Shtetërorë kanë marrë gjithsej 964 masa administrative “gjobë”, sipas paraqitjes grafike sa më poshtë:

**Masa Administrative Gjobë 2021**



## II. QËLLIMI

Qëllimi i inspektimit është mbrojtja e interesit publik dhe për këtë Inspektorati Qendror, si autoritet përgjegjës në zbatim të legjislacionit për inspektimin, edhe përgjatë vitit 2021, ka punuar me përkushtim dhe përgjegjshmëri për përmirësimin e efektivitetit të veprimtarisë inspektuese, duke bërë të mundur që procesi inspektues të jetë sa më transparent dhe për të garantuar konsumatorin për një cilësi sa më të lartë të jetës.

Inspektorati Qendror, nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese për të gjitha inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, ka si qëllim pasqyrimin me objektivitet të përputhshmërisë së kësaj veprimtarie me përcaktimet e parashikuara në ligjin për inspektimin dhe legjislacionin sektorial.

Tashmë, shumica e inspektorateve shtetërore kryejnë inspektime online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, sipas akteve ligjore e nënligjore mbi inspektimin, me rregulla të standardizuara, me synim rritjen e përgjegjshmërisë dhe integritetin e trupave inspektuese në terren.

Inspektorati Qendror, përmes këtij raporti, bën të njohur kryerjen e aktiviteteve të tij, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji për inspektimin dhe ligjet sektoriale, ku kryesisht konsiston në zbatimin e:

- Programit vjetor dhe mujor bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut në formë elektronike nga sistemi unik “*e-Inspektimi*”;
- Kryerjes së veprimtarisë inspektuese online, me procedurë unifikuese nga të gjitha inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjet sektoriale, me tabletë dhe me GPS, nëpërmjet sistemit unik “*e-Inspektimi*”;
- Inspektimeve me fokus zbatueshmërinë e masave anti – Covid;
- Dhënies së kontributit për ndërgjegjësimin e popullatës në zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19;
- Koordinimit të programeve të inspektimit, me qëllim kryerjen e inspektimeve të përbashkëta;
- Mbikëqyrjes së kryerjes së veprimtarisë inspektuese, nga inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese në përputhshmëri me ligjin për inspektimin dhe ligjet sektoriale;
- Ngritjes së kapaciteteve dhe integritetit të inspektorëve nëpërmjet trajnimeve dhe testeve për ligjin mbi inspektimin, ligjet sektoriale dhe inspektimin online;
- Trajtimit me përparësi të ankesave të subjekteve të inspektimit dhe qytetarëve, në lidhje me veprimtarinë inspektuese;
- Hartimin e dokumenteve standarde dhe listë-verifikimeve për fushat e veprimtarisë inspektuese edhe për 42-njësi bashkiake.

### III. METODOLOGJIA

Inspektorati Qendror, ka hartuar raportin e përgjithshëm të inspektimeve në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale, duke siguruar të dhënat e nxjerra nga sistemi “*e-Inspektimi*”, raportimin vjetor të vënë në dispozicion nga inspektoratet shtetërore, ka bërë analizimin e këtyre të dhënave të nevojshme lidhur me procedurën inspektuese, duke nxjerrë në pah problematikat dhe adresimin për zgjidhjen e tyre, si dhe arritjet kryesore të veprimtarisë së tyre inspektuese.

Më konkretisht, procedura e mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, konsiston në analizën e modulit të programimit, çështjeve të inspektimit, raporteve, regjistrin të gjobave, etj., duke shqyrtuar dhe kontrolluar dokumentacionin përkatës të administruar në sistem, përfshirë këtu: programin vjetor, programet mujore të inspektimit, autorizimin, listë verifikimet, procesverbali i inspektimit, vendimi përfundimtar, të dhënat nga regjistri i gjobave, si dhe dokumente të tjera justifikuese të përdorura gjatë veprimtarisë inspektuese.

Të dhënat e analizuar janë marrë nga moduli “Raporte” dhe “Moduli i çështjeve të inspektimit”, me anë të filtrave “hapur nga” dhe “mbyllur deri”, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021.

Një tjetër element i rëndësishëm është edhe informacioni i marrë nëpërmjet raportimit të veprimtarisë së inspektorateve shtetërore, të paraqitura pranë Inspektoratit Qendror, ku është trajtuar materiali në bazë të problematikave të hasura, zgjidhjeve të dhëna, rezultateve të arritura, si dhe objektivat e tyre për të ardhmen.

Në vijueshmëri, ky raport paraqet në formë të përmbledhur arritjet, problematikat, objektivat për Inspektoratin Qendror, inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, të ndara sipas ministrive të linjës, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e veprimtarisë së tyre inspektuese.

#### IV. OBJEKTIVAT

Inspektorati Qendror ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive inspektuese dhe për vitin 2022 ka përcaktuar objektiva të qarta, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e transparencës së procesit inspektues, koordinimin, mbështetjen dhe sigurimin e infrastrukturës për kryerjen e inspektimeve online.

Këto objektiva konsistojnë në:

- ✓ Kryerjen e inspektimeve online nga të gjitha inspektoratet shtetërore, në përputhshmëri me parimet dhe rregullat e ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale;
- ✓ Programimin e inspektimeve mbi bazë tematike dhe me vlerësim risku, duke bërë të mundur uljen e numrit të inspektimeve të panevojshme dhe duke zvogëluar kostot administrative ndaj biznesit;
- ✓ Koordinimin dhe mbështetjen e veprimtarisë inspektuese në tërësinë e komponentëve të saj;
- ✓ Rritjen e transparencës së veprimtarisë inspektuese, për të siguruar besueshmërinë e publikut;
- ✓ Mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese online, nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, të identifikojë problematikat, si dhe të rekomandojë përmirësimin e procesit inspektues;
- ✓ Bashkëpunimin me inspektoratet shtetërore/vendore dhe trupat e tjera inspektuese për përditësimin e listë-verifikimeve dhe dokumenteve standarde, në varësi të ndryshimeve ligjore;
- ✓ Mbështetjen e IKMT, DPAP dhe AKVMB, për kryerjen e inspektimeve online në sistemin elektronik “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Rritjen e performancës, integritetit dhe profesionalizmit të trupave inspektuese nëpërmjet trajnimeve dhe testimeve;
- ✓ Bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore për fillimin e inspektimeve online, nëpërmjet sistemit të inspektimeve;
- ✓ Sigurimin e pajisjeve tabletë për plotësimin e nevojave të inspektorateve shtetërore dhe inspektorateve vendore;
- ✓ Planin Analitik të Projekt akteve duke përfshirë edhe aktet nënligjore: (1) projekt VKM “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 630, datë 14.09.2011, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror”; (2) projekt VKM “Për periudhën maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore për kategori të ndryshme të subjekteve të inspektimit, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë që kryhet, si dhe mënyrën e llogaritjes së saj”; (3) projekt VKM “Për rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit”; (4) projekt VKM “Për procedurën për marrjen dhe trajtimin e mostrave, si dhe metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve në këtë procedurë”.
- ✓

## V. VEPRIMTARIA E INSPEKTORATIT QENDROR PËR VITIN 2021

Inspektorati Qendror, në zbatim të dispozitave ligjore në fushën e inspektimit, nëpërmjet aktiviteteve të kryera edhe përgjatë vitit 2021, ka synuar rritjen e përgjegjshmërisë së procesit inspektues në tërësinë e komponentëve të tij, duke siguruar kryerjen e inspektimeve online, duke trajnuar trajnuar trupat inspektuese, si dhe duke bashkërenduar veprimtarinë inspektuese për të arritur objektivat e përcaktuara si:

- ✓ Hartimi i programeve vjetore të inspektimit bazuar në kritere dhe objektiva sipas metodologjisë së riskut të subjekteve të inspektimit;
- ✓ Përditësimi dhe hartim i listë-verifikimeve të reja, në përgjigje të kërkesave të inspektorateve shtetërore, si dhe implementimin e tyre në sistemin “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese duke identifikuar arritjet, problematikat dhe duke dhënë rekomandime për përmirësimin e procesit inspektues;
- ✓ Koordinimi i Task - Forcës, përmes akteve nënligjore të Inspektorit të Përgjithshëm dhe mbështetja e veprimtarisë inspektuese të inspektorateve shtetërore, sidomos në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19;
- ✓ Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore, ka bërë vlerësimin dhe testimin e aftësive profesionale për 165 inspektorë, në kohë prove, ku marrëdhënia e punës rregullohet sipas Kodit të Punës (AKU – 76; ISHTI – 6; ISHSH – 83).
- ✓ Për rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore gjatë kryerjes së procesit inspektues online, janë trajnuar dhe ritrajnuar 404 inspektorë (AKU – 62; ISHSH – 85; IKMT – 240 dhe AKBPM – 17);
- ✓ Trajnimi i 40 inspektorëve vendorë për Bashkinë Lezhë, sipas një kurrrikule trajnimi për njohjen me kuadrin ligjor mbi inspektimin, si dhe kryerjen e inspektimeve online nga sistemi elektronik “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Për të gjitha inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, në zbatim të pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 10433/2011, u modeluan dhe u printuan gjithsej 260 karta inspektori. (AKU-60; ISHSH-78; ISHMT-12; ISHPSHSH-12; ISHTI-9; IKMT-10; DPA-4; AKBPM-5; DSHPA-4; ZMR-2; AKM-47; AKB-16; DIH-1).
- ✓ Është mbajtur dhe përditësuar Regjistri Kombëtar i inspektorëve në detyrë për inspektoratet shtetërore dhe për inspektoratet vendore, bazuar kjo në lëvizjet e burimeve njerëzore;
- ✓ Integrimi i inspektorateve vendore në sistemin unik të inspektimeve “*e-Inspektimi*”, duke i mbështetur nga ana metodologjike për përshtatjen e dokumenteve standarde, hartimin e listë verifikimeve dhe pajisjen e disa prej tyre me tableta;

- ✓ Përgatitja e paketës së plotë ligjore për amendimin e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fushën e inspektimit;
- ✓ Paraqitja e Projekt ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2021, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pranë Kryeministrisë.
- ✓ Trajtimi dhe shqyrtimi i rreth 70 kërkesa – ankesa, të administruara në formë shkresore dhe elektronike. Objekti i ankesës kryesisht varion nga kërkesa për shqyrtimin e procedurës inspektuese, ankimi për vendimin përfundimtar të inspektimit, denoncime mbi veprimtaritë e subjekteve tregtare, mos respektimi i konkurrencës së ndershme, etj.;
- ✓ Përgatitja dhe miratimi i Programit institucional të Transparencës, të rishikuar, sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar me Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- ✓ Përgatitja dhe miratimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar, sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar me Urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjatë vitit 2021, pranë Inspektoratit Qendror janë administruar 15 kërkesa për informacion, ku 11 prej tyre janë deleguar pranë institucioneve kompetente që administrojnë informacionin e kërkuar dhe 4 janë trajtuar në formë të plotë nga Inspektorati Qendror.
- ✓ Memorandum bashkëpunimi midis Inspektoratit Qendror të Republikës së Shqipërisë dhe Administratës për Çështjet e Inspektimit të Malit të Zi.

## VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS.

### 1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA)

DPA, ka për mision inspektimin për zbatimin e legjislacionit arkivor në të gjitha institucionet pjesë e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë.

Në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017, të Këshillit të Lartë të Arkivave “Rregullore e njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, DPA kryen veprimtarinë inspektuese në sekretari-arkivat e subjekteve shtetërore/private në nivel qendror dhe rajonal.

DPA, për vitin 2021, ka planifikuar 290 institucione për tu inspektuar dhe ka realizuar 270 inspektime, nga të cilat 266 të planifikuara dhe 4 inspektime jashtë planit, si dhe 20 inspektime të anuluar. Inspektimet jashtë planit u kryen në subjekte private me kërkesë të tyre për licencim “arkiv privat”.

Janë marrë 5 masa administrative “gjobë”, ndaj përgjegjësve të drejtpërdrejtë në 5 institucione, për moszbatim të detyrave të caktuara nga inspektimi i mëparshëm, nga të cilat 2 masa administrative “gjobë”, janë revokuar me vendim të Komisionit të Ankimit pranë DPA. Vlera e gjobave është 202 000 lekë dhe nuk janë mbledhur asnjë.

*Arritjet:* DPA, realizon të gjithë veprimtarinë inspektuese online, me tabletë, konform ligjit për inspektimin, nëpërmjet dokumentacionit standard, mbështetur në programin vjetor dhe programet mujore; trupa inspektuese nëpërmjet inspektimit ka mbledhë të dhëna arkivore për të gjitha subjektet shtetërore, që përbëjnë rrjetin arkivor kombëtar, duke krijuar “Databazën me institucione”, si një sistem mirë menaxhimi, monitorimi dhe mbikëqyrës i veprimtarisë së tyre për ecurinë e punës me dokumentet arkivore. Kjo Databazë me të dhëna arkivore të institucioneve do ti ndihmojë edhe në hartimin e planeve vjetore të inspektimit, duke përzgjedhur subjektet për inspektim në bazë të vlerësimit të riskut.

*Problematikat:* Gjatë mbikëqyrjes online të veprimtarisë inspektuese për DPA, u konstatua se trupa inspektuese e DPA, për inspektimet e programuara, duhet të ngarkojë në sistem dokumentin e njofimit të autorizimit nga subjekti i inspektuar; ka mospërputhje midis emërtesës së subjektit të inspektuar me të dhënat e emërtesës të nxjerra nga QKB, për subjektet shtetërore.

*Objektivat:* Për vitin 2022, në bazë të programit vjetor të inspektimit është planifikuar kryerja e inspektimeve në 300 institucione (subjekte), ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të kryhen online dhe me tableta, sipas ligjit dhe rregullave të caktuara për veprimtarinë inspektuese.

## **2. MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

### **2.1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)**

IKMT, në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, VKM nr. 893, datë 04.11.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore, ka si mision ruajtjen dhe sigurinë e ndërtimeve në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislationin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në fushën e mjedisit, pyjeve, burimeve ujore dhe produkteve të ndërtimit, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizimit dhe subsidiaritetit në bazë të ndarjes administrative.

IKMT, me qëllim parandalimin dhe minimizimin e ndërtimeve pa leje në territor, parandalimin dhe kontrollin e mjedisit dhe pyjeve nga veprime të kundërligjshme, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për një mjedis më të pastër në interes të të gjithëve, është e organizuar në të gjithë qarqet e vendit, nëpërmjet drejtorive rajonale.

Gjatë vitit 2021, IQ në bashkëpunim me IKMT ka trajnuar 240 inspektorë, pra të gjithë trupën inspektuese në qendër dhe në drejtoritë rajonale në qarqe, duke ju krijuar mundësinë e ushtrimit të veprimtarisë inspektuese online nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”, në përputhje me bazën ligjore me të cilën operon IKMT. Është përmirësuar seti i dokumenteve dhe listat e verifikimit sipas fushave të inspektimit që mbulon, por prapë IKMT nuk realizoi procesin inspektues online dhe veprimtaria inspektuese u realizua përsëri me blloqe.

Nga të dhënat e nxjerra nga raporti vjetor i IKMT, u vu re se ka kryer gjithsej 4555 inspektime në territor dhe nga këto ka mbajtur 340 vendime: 183 vendime për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm” dhe “Pezullimin e Punimeve në Ndërtim”, 81 vendime për “Dënim me gjobë” të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje, 76 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet e ndërtimit/burimet ujore.

Për vitin 2021, janë vendosur gjoba dhe bashkë me kamatëvonesat arrijnë në vlerën 553 298 818 lekë, ku janë arkëtuar 1 800 000 lekë, si dhe gjoba të shfuqizuara në vlerën 800 000 lekë.

Janë realizuar 296 prishje të objekteve të kundërligjshme, 38 të objekteve të cilat janë shpronësuar me VKM dhe 22 objekte të prishura nga tërmeti i 26 Nëntorit. Në total për vitin 2021, janë prishur 356 ndërtime/objekte nga ana e IKMT.

Edhe për vitin që kaloi, IKMT ka patur në fokus inspektimet në zonat bregdetare, me përparësi turizmin dhe zona të tjera me rëndësi kombëtare. Gjithashtu, ka vazhduar angazhimi me intensitet të lartë për të qenë në mbështetje të procesit të rindërtimit nga tërmeti i 26 Nëntorit, lidhur me prishjen e objekteve që cenojnë jetën e banorëve dhe ndërtesave përreth, në zonat e prekura.

IKMT, në kuadër të zbatimit të projekteve madhore të Qeverisë Shqiptare, ka ndërmarrë veprime në projektet: Projekti Infrastrukturor “Unaza e Madhe e Tiranës”, Loti II dhe III; 34

Objekte/ndërtime janë prishur për lirim të sheshit të ndërtimit për projektin infrastrukturor “Unaza e Madhe e Tiranës”, në Bashkinë Tiranë; Projekti i “Ndërtimit të Banesave Sociale” në qytetin e Burrelit, ku është prishur një objekt industrial me sipërfaqe 3000 metra katror; Projekti “Rikonstruksioni i rrugës së Kalasë Tepelenë”, ku janë prishur 10 objekte për lirim të sheshit të ndërtimit për këtë projekt; Plani i ri i Bashkisë Kamëz për zhvillimin e fshatit Valias, ku është prishur një objekt për lirim të sheshit të ndërtimit për këtë projekt; Projekti “ Shtesë e impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm, Bovillë”, duke prishur 20 objekte për realizimin e këtij projekti.

IKMT, me kalimin e përgjegjësi në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave dhe pyjeve, ka punuar me intensitet për kontrollin dhe inspektimin në terren, duke marrë masa ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari të paligjshme në dëm të mjedisit, si dhe në total vlera e gjobave të vendosura ndaj këtyre subjekteve është 72.3 milion lekë.

Nga IKMT, Drejtorja e Inspektimit të Pyjeve, Qendër, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale, gjatë vitit 2021, kanë realizuar 526 inspektime me fokus në zbatimin e ligjshmërisë në fondin pyjor, kullor, mbrojtjen e pyjeve nga dëmtimet, prerjet, zëniet e përdorimet e paligjshme të fondit pyjor e kullor, zjarret, mbrojtjen e faunës së egër, zbatimin e moratoriumit në gjueti, pyje dhe bimëve medicinale etanifere.

*Problematikat:* Nuk kryejnë inspektime online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, si një proces i rregullt administrativ; janë hasur problematika në lidhje me identifikimin e subjekteve posedues apo prona të inspektuara, marrjen e informacioneve nga autoritetet planifikuese dhe inspektuese të qeverisjes vendore, në lidhje me dokumentacionin mbi ligjshmërinë e objekteve/ndërtimeve të inspektuara; kalimi i kompetencave në fushën e mjedisit, ajrit, ujit dhe tokës, ndryshimi i strukturës dhe lëvizja e burimeve njerëzore.

*Objektivat:* Evidentimi, inspektimi dhe prishja e objekteve/strukturave/moleve në zonën bregdetare në kuadër të vijimit të aksionit “Bregdeti Ynë”, si prioritet i Qeverisë; ndërhyrja ndaj ndërtimeve, pengesë për zhvillimet e projekteve me interes publik; mbrojtja e mjedisit dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse sidomos me Policinë e Shtetit për kontrollin dhe mbrojtjen e territorit dhe mjedisit; evidentimi e procedimi i rasteve të prerjeve të paligjshme, tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, pushtimit, shpërdorimit, degradimit, tjetërsimit të pyjeve dhe të tokës pyjore, nga ndërhyrjet e pakontrolluara në Fondin Pyjor dhe Mjedisin Natyror.

### **3. MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

#### **3.1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHS)**

ISHPSHS ka si mision të përgjithshëm kontrollin, konstatimin, këshillimin, njoftimin, formimin, zbutjen e konflikteve, parandalimin dhe sanksionimin, në fushën e punës dhe standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në zbatim të VKM nr. 295, datë 20.03.2013, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, nëpërmjet inspektimit, siguron zbatimin e ligjshmërisë për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave, jep të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efektive të shqyrtimit të dispozitave ligjore, etj.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar - Qershor 2021, ISHPSHSH ka qenë e përfshirë vetëm në inspektime jashtë plani, duke devijuar nga planifikimi i përmuajshëm dhe këto inspektime janë kryesisht ankesa, aksidente, indicie, shkelje flagrante apo kërkesa nga subjektet, si dhe verifikime të masave anti – Covid, vetëm ose në bashkëpunim me institucione të tjera (kjo sipas rajoneve e prefekturave).

Inspektimet për 6 - mujorin e dytë të vitit 2021 janë të planifikuara dhe me orientim në subjektet me historik aksidenti, me problematika lidhur me zbatimin e legjisllacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe me fokus mbrojtjen e popullatës për shkak të pandemisë, duke sjellë edhe një qasje ndryshe dhe më informuese e këshilluese ndaj biznesit, punëdhënësve e punëmarrësve.

Gjithashtu, ndryshimi i strukturës pati ndikim në lëvizjen dhe pozicionin e punës së burimeve njerëzore, ku organizimi i ri u bë me 6 drejtori rajonale (Tiranë, Vlorë, Dibër, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë) dhe organika nga 154 punonjës që ishte, kaloi në 165 punonjës total. Aktualisht, janë pa u plotësuar edhe 22 vende vakante. Janë marrë disa masa disiplinore për vitin 2021, “Vërejtje” nga eprorët direkt për 8 inspektorë, të ndara sipas rajoneve: 1 në Dibër, 1 në Durrës, 2 në Tiranë, 1 në Lezhë dhe 3 në Gjirokastrë.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021, ISHPSHSH ka kryer 7628 inspektime gjithsej, nga të cilat 5995 të programuara dhe 1633 jashtë programit, si dhe janë marrë 102 masa administrative “gjobë”.

Janë marrë gjithsej 1 440 masa administrative, nga të cilat 524 masa urgjente për shkelje të marrëdhënieve të punës, 54 masa urgjente për shkelje të sigurisë dhe shëndetit në punë, 760 masa të dënimit kryesor “paralajmërim”, 102 masa të dënimit kryesor “gjobë”.

Gjatë vitit 2021 janë vendosur 102 gjoba për shkelje të dispozitave ligjore dhe nga këto:

- ✓ 58 gjoba gjatë inspektimeve për aksidente në punë;
- ✓ 20 gjoba gjatë inspektimeve për ankesa, denoncime nga të tretët;
- ✓ 21 gjoba në inspektime të programuara;
- ✓ 3 gjoba në inspektime rastësore.

Janë ankimuar dhe shqyrtuar 39 raste në Komisionin e Ankimit të Gjobave, për të cilat në:

- ✓ 3 raste është marrë vendimi për ulje të vlerës (ndryshuar);
- ✓ 3 raste ndryshuar vendimi nga gjobë në paralajmërim;

- ✓ 3 raste është shfuqizuar vendimi përfundimtar i inspektimit;
- ✓ 30 raste janë lënë në fuqi vendimet përfundimtare të inspektimit.

Janë ankimuar në gjykatë 32 procese gjyqësore, ku nga këto:

- ✓ 19 raste gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë;
- ✓ 6 raste gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë;
- ✓ 7 raste vazhdojnë në gjykim në shkallë të parë, për të cilat nuk ka ende një vendim gjykatë.

Për vitin 2021, arkëtime dhe kamatëvonesa nga gjrobat janë në vlerën 22 294 176 lekë.

*Arritjet:* Kryerja e inspektimeve online në të gjitha rajonet, zhvillimi i platformës “matrica e dënimeve”, duke synuar që kjo platformë të jetë platforma informuese, ndërgjegjësuere dhe e aksesueshme nga punëdhënës e punëmarrës, si në drejtim të marrjes së informacionit bazë mbi detyrimet e legjislacionit të punës, ashtu edhe nëpërmjet koordinimit e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku.

*Problematikat:* Për sa i përket procesit inspektues online, veprimtaria inspektuese në rajonet Dibër dhe Shkodër nuk është realizuar me tabletë; ka disa mangësi në plotësimin e akteve administrative në të gjitha fushat e tyre si: në plotësimin e kohëzgjatjes së inspektimit dhe shtyrjes së autorizimit, në disa raste procedura e inspektimit është realizuar jashtë afateve të përcaktuara në autorizim, procesverbali nuk firmoset nga trupa inspektuese dhe personi i autorizuar i subjektit, si dhe nuk dokumentohet njoftimi i procesverbalit subjektit, objekt inspektimi, ka raste kur në vendimin përfundimtar të inspektimit konstatohet shkelja e kërkesave ligjore dhe nuk merret masë administrative, në përputhje me ligjin përkatës për shkeljen e konstatuar; kur gjetja e konstatuar nuk parashikon masë administrative nuk merret as dënim kryesor “paralajmërim”, në përputhje me pikën 1, të nenit 48 të ligjit për inspektimin, por lihen vetëm detyra për t’u korrigjuar.

*Objektivat:* Vazhdimin e punës dhe zhvillimin më tej të platformës “platforma informuese e ndërgjegjësuere”, e aksesueshme dhe nga punëdhënës e punëmarrës në drejtim të marrjes së informacionit bazë mbi detyrimet e legjislacionit të punës; ndërgjegjësim i vazhdueshëm për zbatimin e dispozitave të legjislacionit të punës nëpërmjet informimit, këshillimit, shpërndarjes së informacionit me anë të çdo burimi si: faqja e web, fletëpalosja, takime me partnerët socialë, fushata sensibilizuese, media; rritja kapaciteteve inspektuese në drejtim të eficiencës dhe cilësisë së inspektimit, zbatimi dhe dokumentimi korrekt i procedurës inspektuese, me qëllim ndërhyrjet me masat ligjore të parashikuara nga këshillimi e deri tek ndëshkimi, duke synuar rritjen e nivelit të zbatimit të legjislacionit të punës nga punëdhënës e punëmarrës; rritja e kontroleve në subjektet shtetërore duke synuar minimizimin e konflikteve të marrëdhënieve të punës, si një trend në rritje kohët e fundit nga rastet e ankesave të adresuara pranë institucionit; forcimi i bashkëpunimit për shkëmbim informacioni si: Tatim-Taksat, Sigurimet Shoqërore, Agjencinë e Prokurimit Publik etj.

Inspektimi i standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, përmes garantimit të cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror; forcimi i kapaciteteve inspektuese të Drejtorisë së

Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, përmes implementimit të Programit të Bashkëpunimit me UNICEF, ku Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, si një nga aktorët kryesorë të reformës së shërbimeve shoqërore, në partneritet me UNICEF, do të përfshijë dhënien e ekspertizës dhe promovimin e inspektimit të shërbimeve sociale në të gjitha forumet, tryezat, grupet e punës, që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale, zhvillimin e politikave sociale, si edhe në lidhje me rritjen e kapaciteteve të trupës inspektuese.

### *3.2 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)*

ISHMT, ka si mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale.

ISHMT ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM nr. 36, datë 20.1.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore, duke inspektuar zbatimin e kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, mbrojtjes së pronësisë industriale, garantimit të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si dhe të inspektimit metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë.

Trupa inspektuese e ISHMT ka aktualisht në përbërje 55 inspektorë, krahasuar me 66 inspektorë që duhet të ketë sipas strukturës së miratuar, sipas drejtorive: 38-Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve dhe 17-Drejtoria e Pronësisë Intelektuale.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, ISHMT ka kryer në total 1745 inspektime, nga të cilat 1465 inspektime të programuara dhe 280 jashtë programit mbi bazë ankese, sipas drejtorive:

- ✓ Mbikëqyrja e produkteve jo ushqimore – 1221 inspektime, nga të cilat 959 inspektime të programuara dhe 262 inspektime jashtë programit me bazë ankese;
- ✓ Pronësia intelektuale – 524 inspektime, nga të cilat 506 inspektime të programuara dhe 18 inspektime të paprogramuara, mbi bazë ankese.

Trupa inspektuese ka marrë 239 masa administrative në total, nga të cilat 93 paralajmërimet, 123 gjoha dhe 23 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar 8124 produkte, nga të cilat 327 kanë qenë jo në konformitet.

Janë ankimuar dhe shqyrtuar 66 vendime administrative nga Komisioni i Ankimit të Gjobave, për të cilat:

- ✓ 35 masa administrative “gjobë” janë rrëzuar;
- ✓ 31 masa administrative “gjobë” janë lënë në fuqi.

Janë ankimuar në gjykatë 23 vendime administrative, ku nga këto:

- ✓ 9 çështjeve i është rrëzuar kërkesë-padia nga ana e subjekteve ankimuese;
- ✓ 5 çështjeve u është pranuar kërkesë-padia kundër ISHMT;
- ✓ 9 çështje janë në proces gjyqësor.

Për vitin 2021, arkëtimet nga gjrobat janë në vlerën prej 9 050 071 lekë.

*Arritjet:* Kryerja e inspektimeve online, me dokumentacionin standard, konform ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale në fuqi; ndikimi në uljen e mos-konformiteteve të produkteve jo ushqimore, si dhe në respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2021; inspektime të vazhdueshme dhe të rregullta në treg, të shoqëruara nga fushata sensibilizuese; bërja e evidente e ISHMT në tregun e produkteve jo ushqimore dhe në fushën e respektimit të pronësisë intelektuale; informimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe informimin e operatorëve ekonomikë, për të respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara, për të ofruar në treg produkte të sigurta, si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

*Problematikat:* Lidhur me veprimtarinë online të inspektimit, veprimtaria inspektuese nuk është realizuar me tabletë, duke mos nënshkruar elektronikisht aktet administrative të inspektimit; ka mospërputhje të subjekteve të planifikuara për t'u inspektuar, sipas programeve mujore të sjella me shkresë pranë Inspektoratit Qendror, me subjektet e planifikuara dhe të gjeneruara në sistem për muajt përkatës; inspektimet realizohen pa njoftim paraprak; ka pasaktësi dhe mangësi në plotësimin e akteve administrative në të gjitha fushat e tyre; ka mangësi në vlerësimin e sigurisë së produkteve nëpërmjet aparaturave dhe pajisjeve, si pasojë e numrit të kufizuar të këtyre pajisjeve dhe aparaturave, por edhe nga mungesa e trajnimeve më të avancuara për përdorimin e tyre; nuk ka një procedurë për produktet që duhet t'i nënshtrohen analizave laboratorike në laboratorë të huaj; mos përditësimi i adresave të subjekteve në QKB, sjell që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden në adresat e deklaruara; ka vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve, si pasojë e mungesës së automjeteve për inspektim.

*Objektivat:* Në vitin 2022 janë parashikuar të realizohen 2498 inspektime të programuara dhe 588 të pa programuara, nga të cilat 1877 inspektime të programuara dhe 469 të pa programuara në fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve jo ushqimore dhe 621 inspektime të programuara dhe 119 të pa programuara në fushën e pronësisë intelektuale; informimi i operatorëve ekonomikë për zbatimin e kriterëve ligjore mbi sigurinë e produkteve jo ushqimore dhe mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi sigurinë e produkteve dhe mbi të drejtat e tyre si konsumator; fuqizimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të stafit për rritjen e shkallës së njohurive në fushat përkatëse; rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të pronësisë intelektuale, si dhe fuqizimi i bashkëpunimit të ISHMT me Autoritetet e Mbikëqyrjes së Tregut të vendeve të rajonit për shkëmbim eksperience dhe të përvojave më të mira.

## 4. MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

### 4.1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)

ISHTI, ka si mision të përgjithshëm inspektimin në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të garantimit të sigurisë së njerëzve nga rreziqet e shfryrjeve dhe të shpërthimeve të shkaktuara nga pajisjet nën presion, nga pajisjet dhe instalimet elektrike, si dhe ushtron funksionin e tij rregullator në përputhje me nevojat e vendit, të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurimit publik, duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut.

Në zbatim të VKM nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial” dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 105, datë 13.08.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, ISHTI realizon funksionin inspektues nëpërmjet katër drejtorive: (1) Drejtoria e Inspektimit të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve (DINGN); (2) Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion (DIPNP); (3) Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN); (4) Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK), si dhe është e organizuar në nivel qendror.

ISHTI, për periudhën kohore Janar -Dhjetor 2021, ka realizuar gjithsej 6420 inspektime online, ku prej të cilave, 5803 janë të programuara dhe 617 inspektime jashtë programit.

Gjatë vitit 2021, janë vendosur në total 78 masa administrative “gjobë”, ku 13 subjekte kanë likuiduar vullnetarisht masën administrative me vlerë 2 190 000 lekë.

Janë trajtuar 56 ankimime nga gjykata, ku ka lëshuar urdhra ekzekutiv për 52 vendime gjobash, ndërsa 4 kërkesa janë shfuqizuar me vendim gjykate të formës së prerë. Mbeten për t’u dërguar edhe 9 kërkesa për lëshim urdhri, pasi nuk është plotësuar afati ligjor i kërkesës.

4.1.1. Drejtoria e Inspektimit të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve ushtron veprimtarinë e saj inspektuese në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për zbatimin e kushteve të parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse, që u janë dhënë personave juridik, në instalimet, impiantet dhe pajisjet e përdorura, në mënyrë që ato të zbatojnë normat teknike dhe masat mbrojtëse kundër zjarrit.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, ka realizuar në total 1118 inspektime online, ku prej të cilave 1006 inspektime janë të programuara dhe 112 inspektime jashtë planit. Trupa inspektuese e kësaj drejtorie ka vendosur 15 masa administrative “gjobë”.

4.1.2. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion, ushtron aktivitetin inspektues në subjektet që kanë në përdorim të gjitha llojet e pajisjeve, të cilat konsiderohen pajisje nën presion, subjekte këto shtetërorë apo privatë, të cilët kanë të instaluar pajisjet: Rezervuar GLN, Rezervuar Ajri, Rezervuar Kriogjenik (Oksigjeni, Azoti, Gazi Karbonik, etj.), Kaldaja Avulli, Autoklava etj.

Gjatë vitit 2021, ka realizuar në total 3515 inspektime online, ku prej të cilave 3137 inspektime të programuara dhe 378 inspektime janë jashtë planit, si dhe janë vendosur 17 masa administrative “gjobë”.

4.1.3. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike, ka në fokus të aktivitetit të saj, garantimin e sigurisë së njerëzve dhe vlerave materiale nga rreziku elektrik. Gjatë vitit 2021, ka realizuar në total 1787 inspektime online, ku prej të cilave 1660 inspektime të programuara dhe 127 inspektime jashtë planit. Gjohat e vendosura në total janë 46, nga të cilat 21 janë vendosur gjatë procesit online të inspektimeve dhe 25 gjoba janë për rastet e aksidenteve në punë. Gjatë këtij viti kanë ndodhur gjithsej 19 aksidente, nga këto 16 aksidente me pasojë vdekjen dhe 3 aksidente me plagosje. Shkaqet e aksidenteve të këtij viti, sipas problematikës, janë si pasojë e:

- ✓ Mos zbatimit të procedurave të punimit;
- ✓ Ndërhyrjeve të paligjshme në ambientet elektrike për qëllime të ndryshme.

4.1.4. Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare, ka si objekt inspektimin veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazit, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit. Objekti i inspektimeve teknike ka të bëjë me aspektet teknike të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të instalimeve dhe pajisjeve që shërbejnë për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe terminalet e gazit natyror të lëngëzuar.

DSKIG, për vitin 2021 nuk ka kryer inspektime online, pasi akoma nuk ka finalizuar hartimin e formatit të listë-verifikimit sipas fushës që mbulon.

#### 4.1.5. Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve

Drejtoria e Laboratorit Qendror, në aktivitetin e saj, ka si objekt kryerjen me përgjegjësi të analizave laboratorike të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve, si dhe analizave të detergjenteve të ndryshëm, letrës, lëkurës dhe këpucëve në Laboratorin e Tekstit.

Gjatë vitit 2021, u testuan gjithsej 6663 kampione nga të cilat 2198 kampione të marra në dogana dhe 4410 kampione të marra për tregun e brendshëm, ku: 1194 kampione janë sondazhe, 3216 kampione janë të plota, 55 kampione janë palë e tretë.

Nga analizimi i 2 kampioneve, përkatësisht 1 gazoil dhe 1 GLN, kanë rezultuar me shmangie ngastandardi. Në 27 korrik 2021 u arrit fitimi i statusit “Laborator i Akredituar”. Certifikata e Akreditimit, përcakton qartë që Laboratori jep dëshmi dhe ka aftësi teknike e profesionale të lartë.

Laboratori i Porto-Romanos ishte një nisëm që prej 2019 dhe përfundoi në 2020, i cili ndikoi drejtpërdrejtë në cilësinë e procesit të analizimit të mostrave të hidrokarbureve, por njëkohësisht duke ulur ndjeshëm kohën e pritjes për subjektet, nga 12 orë që është aktualisht, në 4 orë. Laboratori do të kontrollojë cilësinë e 80% të hidrokarbureve që do të importohen dhe eksportohen.

## Laboratori i Tekstilit

Synimi kryesor i Laboratorit gjatë muajve të parë të këtij viti, ka qenë implementimi i metodikave të reja, trajnim i personelit me qëllim rritjen e cilësisë në kryerjen e analizave dhe përcaktimeve laboratorike, si dhe futjen e aparaturave të reja bashkëkohore në të ardhmen me qëllim rritjen e numrit të komponentëve të analizuar.

Gjatë vitit 2021, në Laboratorin e Tekstilit janë kryer kryesisht analiza detergjentesh të ndryshëm, solucione për larje dyshemeje, sapun likuid, larës rrobash, pastrues yndyrë, sapun rrobash etj.

*Arritjet:* Nga mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese rezulton se procedura e inspektimit e ndjekur nga ISHTI, kryhet online me dokumente standarde dhe në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjet sektoriale; Laboratori i ISHTI-t, ka marrë statusin si “Laborator i Akredituar”, për nxjerrjen e analizave të produkteve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të saj; Autolaboratori mobile është vënë në punë për qëllime të kontrollit operacional dhe marrjes së informacionit për cilësinë e nënprodukteve të naftës në çdo vendndodhje me anë të të cilit mund të analizohen 5 tregues kryesor të benzinës ose gazoilit në më pak se 20 minuta, si dhe është vënë në funksion laboratorit i analizave të naftës e nënprodukteve të saj, në mjediset e Porto Romanos, gjë e cila ka një impakt pozitiv për biznesin, kryesisht në kohën e analizimit të produkteve.

*Problematikat:* Për sa i përket procesit inspektues online, ISHTI vazhdon të ketë mospërputhje të subjekteve të planifikuara për t’u inspektuar, sipas programeve mujore me subjektet e planifikuara dhe të gjeneruara në sistem për muajt përkatës; për inspektimet e programuara, nuk kryhet njoftimi paraprak i inspektimit; për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore nuk lihen afate kohore, si dhe ka raste të dublimit të gjobës; nevojat për përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me rregullat e normave teknike për miratimin e standardit të gazit të lëngët dhe sigurinë nga rreziku elektrik; aparatet e defektuara; vazhdon të mbetet emergjente krijimi i kushteve të ventilim–aspirimit të dhomave ku ruhen kampionet; për limitimin e rrezikut të eksplodimit dhe kontaminimit të personelit është e domosdoshme vendosja e detektorëve për tejkalimin e përqendrimit të nivelit të gazit dhe të avujve hidrokarbure të dëmshëm për shëndetin e personelit dhe eliminimin e ndonjë zjarri të mundshëm; trajnimi i inspektorëve, për ngritjen e nivelit profesional në lidhje me veprimtarinë inspektuese të tyre; mungesa e logjistikës (automjete, aparatura, ambiente). Janë ende pa u zgjidhur problematikat me aparatet e defektuara si: Rigaku, aparati i përcaktimit të squfurit në vlera të ulëta; Aparati i përcaktimit të koksit kondrason në gazoil; Aparati i përcaktimit të Numrit Motorik të Oktanit në benzinë dhe aparati i përcaktimit të DVPE-së (presionit të avujve në benzinë) nuk janë në gjendje pune.

*Objektivat:* Rritja e nivelit të respektimit të cilësisë sipas standardeve dhe rregullave teknike për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre në tregun e brendshëm, nëpërmjet kontrolleve cilësore të planifikuara; realizimi i kontrolleve për respektimin e kushteve sipas lejeve të marra për të gjitha instalimet për depozitimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, me

pakicë dhe shumicë, në shoqëritë e pajisura me licencë tregtimi; inspektive për kontrollet cilësore në të gjithë subjektet e tregimit me shumicë e pakicë, me qëllim që gjithë produktet që u ofrohen konsumatorëve të jenë konform standardeve të miratuara; vazhdimi i ecurisë së punës për krijimin e bazës së të dhënave për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike; përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me rregullat e normat teknike për miratimin e standardit të gazit të lëngët dhe sigurinë nga rreziku elektrik, si dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

#### **4.2 Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)**

AKSEM, është autoriteti përgjegjës, i cili kryen veprimtari inspektuese në fushën e sigurisë në punë, të emergjencave dhe shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike. Ky institucion e zhvillon veprimtarinë inspektuese në bazë të ligjit nr. 135/2016, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike” dhe VKM nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar për sigurinë dhe emergjencat në miniera”, si dhe akte të tjera nënligjore në fuqi.

AKSEM, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, kryen inspektive në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në:

- i) Minierat nëntokësore me regjim gazi, të cilat inspektohen jo më pak se 3 (tre) herë në vit;
- ii) Minierat nëntokësore pa regjim gazi dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, të cilat inspektohen jo më pak se 2 (dy) herë në vit;
- iii) Minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve, të cilat inspektohen jo më pak se 1 (një) herë në vit.

Nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit të inspektimit “*e-Inspektimi*”, rezulton se AKSEM, gjatë vitit 2021 ka realizuar 519 inspektive, nga të cilat 479 janë të programuara dhe 40 inspektive jashtë programi.

Kanë marrë dënime administrative kryesore paralajmërim 47 subjekte, ndërsa kanë marrë 9 Vendime Përfundimtare të Inspektimit me masë administrative gjobë me vlerë 2 650 000 lekë, ku janë arkëtuar 3 masa me vlerë 900 000 lekë.

Nga Komisioni i ankimit është shqyrtuar vetëm 1 gjobë, e cila është lënë në fuqi. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë është shqyrtuar 1 çështje e cila është lënë në fuqi.

*Arritjet:* AKSEM, realizon veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin për inspektimin, me dokumentacion standard, online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”, me program vjetor dhe programe mujore të gjeneruara në portalin unik të inspektimit.

*Problematikat:* AKSEM, nuk realizon veprimtarinë inspektuese me tabletë, duke bërë të pamundur verifikimin nëse procedura e inspektimit është mbajtur pranë dhe në prani të subjektit objekt inspektimi; në disa raste, ka pasaktësi në plotësimin e formateve të dokumentacionit të veprimtarisë inspektuese dhe mangësi në dokumentimin e dosjes së inspektimit; dosja e inspektimit nuk dokumentohet me njoftimin e autorizimit, njoftimin e procesverbalit, dokumentacion shoqërues për gjetjet e konstatuara apo kur inspektimi është jashtë programi.

Në modulën “Gjobat”, nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti) nga personi përgjegjës.

*Objektivat:* Inspektimet në subjektet nëntokësorë me regjim gazi, të cilat vlerësohen subjekte me nivel risku të lartë dhe duhet të kontrollohen të paktën 3 herë në vit; subjektet nëntokësore pa regjim gazi, të cilat vlerësohen si subjekte me nivel risku të mesëm, këto subjekte duhen të kontrollohen të paktën 2 herë në vit; subjekte sipërfaqësore, të cilat vlerësohen si subjekte me nivel risku të ulët dhe duhet të kontrollohen të paktën 1 herë në vit; subjekte të veprave hidro-energjitike; fabrika pasurim, të paktën një herë në vit; galeritë e mbyllura si dhe inspektimet që mund të dalin jashtë programi si rezultat i revokimit të subjekteve minerare nga ana e ministrisë.

#### **4.3 Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH)**

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor në zbatim të Ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, Rregullores nr.11, datë 17.09.1988, “Për dhënie, heqjen e dëshmisë së aftësisë dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative në hekurudhë”, Rregullores nr.14, datë 30.09.1988, “Për mirëmbajtjen e vijave hekurudhore”, është autoriteti përgjegjës që nëpërmjet inspektimit garanton sigurinë në hekurudha.

DIH, ka realizuar 48 inspektime online brenda programit, duke realizuar në masën 100% inspektimet e programuara, por veprimtaria inspektuese ka qenë e kushtëzuar edhe përgjatë vitit 2021, për arsye se Hekurudha Shqiptare ka patur një aktivitet tepër të kufizuar.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 nga inspektorët dhe ndihmës inspektorët janë kryer 200 monitorime, të cilat kryesisht në njësitë hekurudhore me risk të lartë, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes së vijës hekurudhore, rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtarëve, përmirësimin e kushteve në pjesën e sipërme të vagonëve, plotësimi me ndriçim të vazhdueshëm gjatë lëvizjes për çdo vagon etj.

*Arritjet:* DIH, realizon veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin për inspektimin, me dokumentacion standard, online, me tabletë nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”.

*Problematikat:* Baza ligjore tek listë verifikimet e pa përditësuar, mos njoftimi i autorizimit të inspektimit; dokumentacioni i inspektimit nuk plotësohet në të gjitha rubrikat e duhura; niveli profesional i punonjësve, i cili nuk është ai që kërkohet edhe pse janë marrë masa nga Administruesit e Infrastrukturës Hekurudhore dhe Ndërmarrjet Hekurudhore.

*Objektivat:* Përditësimi i bazës ligjore tek listë verifikimet; bashkëpunimi me Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore dhe Sipërmarrësit Hekurudhorë për ngritjen e nivelit të sigurisë hekurudhore; testimi periodik i aftësive profesionale të punonjësve hekurudhorë që ushtrojnë funksione të sigurisë; rritja e bashkëpunimit me Inspektoratin Qendror, Agjencinë e Bashkimit Evropian të Hekurudhave (ERA), Institutin e Transportit, Autoritetin Rregullativ Hekurudhor të Kosovës dhe autoritetet homologe të rajonit; monitorimi në vazhdimësi i vijave hekurudhore me risk të lartë, urave dhe veprave të artit dhe ndërrueseve hekurudhore në stacionet hekurudhorë.

## **5. MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

### **5.1. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP)**

DPAP ka si mision të përgjithshëm ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe është pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse, që kontribuon në realizimin e këtij qëllimi.

DPAP ushtron funksionet e saj mbështetur në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrit nr. 254, datë 30.04.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, si dhe urdhra dhe udhëzime të tjera të MASR në fushën e arsimit.

DPAP është e përbërë nga një trupë inspektuese prej 22 specialistësh dhe ushtron veprimtarinë e saj në nivel qendror dhe rajonal, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Sektorit të Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë.

Nga mbikëqyrja për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021, rezulton se DPAP nuk është përdorues i sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, pavarësisht se nga ana e Inspektoratit Qendror, është siguruar infrastruktura e duhur për realizimin e procesit inspektues. Janë përshtatur dhe implementuar në sistemin “*e-Inspektimi*”, dokumentet standarde të inspektimit dhe përditësuar listë-verifikimet sipas ndryshimeve ligjore që ka pësuar ligji i tyre sektorial. Gjithashtu pajisur trupa inspektuese e DPAP me 10 tableta, si dhe është bërë edhe trajnim i trupës inspektuese.

Për vitin 2021, referuar të dhënave të marra nga raporti vjetor lidhur me monitorimet, vlerësimet dhe inspektimet, DPAP, ka kryer gjithsej:

- ✓ 184 vlerësime/monitorime;
- ✓ 104 vlerësime/inspektime në institucionet e arsimit parauniversitar publik sipas DRAP (Durrës Korçë, Fier, Lezhë);
- ✓ 15 vlerësime/inspektime në institucionet e arsimit parauniversitar privat;
- ✓ 7 vlerësime/inspektime në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP);

- ✓ 6 vlerësime/inspektime në institucionet e arsimit (IA) parauniversitar publik/privat bazuar në ankimimet.

Janë vendosur 7 dënime administrative “Ndërprerje e menjëhershme e veprimtarisë”, 1 pezullim licence, për institucionet arsimore jopublike.

*Arritjet:* Gjatë vitit 2021, janë realizuar trajnime në kuadër të programit “Shkollat e Shekullit të 21”, lidhur me aftësitë e drejtuesve të shkollave dhe mësuesve për përdorimin e metodave të mendimit kritik dhe të zgjidhjes problemore dhe teknologjisë në mësimdhënie; pjesëmarrje si anëtarë në Komisionin *ad-hoc* për procedurën e konkurrimit të psikologëve dhe punonjësve social dhe në grupin qendror ndërinstitutional; trajnime nga ASCAP për programet dhe veçoritë e mësim dhënies në klasat e I, trajnim i rreth 25 mësuesve të klasave të I, të gjuhës Angleze ofruar nga Ambasada e SHBA në Tiranë, grumbullim i raportimeve mbi rezultatet e punës nga koordinatorët e ZVAP-ve, pjesëmarrje si anëtarë e grupit të punës për procesin e analizës së Maturës Shtetërore në vite, etj.

*Problematikat:* DPAP, edhe për vitin 2021, nuk realizoi inspektime online, por të gjithë veprimtarinë inspektuese e realizoi me blloqe, pavarësisht se Inspektorati Qendror ka siguruar të gjithë infrastrukturën e duhur.

*Objektivat:* Vlerësimi dhe inspektimi i zbatimit të kërkesave ligjore nga institucionet arsimore dhe institucionet e varësisë; zgjidhja e ankimeve të ardhura nga nxënës, mësues dhe të tjerë, si dhe marrja e masave nga DPAP; bashkëpunim në vijueshmëri me ASCAP dhe MARS për trajnimin dhe kualifikimin e stafit mësimor apo punonjësve të tjerë jo mësimor; rritja e numrit të monitorimeve dhe vlerësimeve në institucionet arsimore publike dhe private.

## **6. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në juridiksionin e saj dy inspektorate shtetërore.

### **6.1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)**

AKU zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar, VKM nr. 708, datë 09.09.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, si dhe Urdhrit nr. 128, datë 26.10.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.

AKU është e organizuar në 12 drejtori rajonale, si dhe ka 3 sektorë inspektimi, përkatësisht:

1. Sektori i inspektimit të ushqimit dhe ushqimit për kafshët me origjinë jo shtazore;
2. Sektori i inspektimit të ushqimit dhe ushqimit për kafshët me origjinë shtazore;
3. Sektori i mbrojtjes së bimëve dhe imputeve bujqësore.

AKU kryen inspektime në fushat e inspektimit, sa më poshtë:

1. Inspektimi i ushqimit për kafshët me origjinë jo shtazore;

2. Inspektimi i ushqimit dhe ushqimit për kafshët me origjinë shtazore;
3. Inspektimi për mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore;
4. Inspektim për IPARD;
5. Inspektive në PIK.

Gjatë vitit 2021, AKU ka kryer 33418 gjithsej, nga të cilat 28300 të programuara dhe 5118 jashtë programit të inspektimit. Gjithashtu, rezulton se për këtë periudhë janë marrë 239 masa administrative “gjobë”, të shpërndara në drejtoritë rajonale, si dhe janë arkëtuar me një vlerë prej 40 507 804 lekë.

*Arritjet:* Programi vjetor i inspektimit është hartuar sipas metodologjisë së unifikuar të Inspektoratit Qendror, nëpërmjet sistemi “e-Inspektimi”; që nga muaji gusht 2021, programet mujore të rishikuara të inspektimit, janë paraqitur nga disa DRAKU, pranë Inspektoratit Qendror për mendim këshillimor, sipas kërkesave ligjore në fuqi; janë hartuar disa listë-verifikimi të reja apo përmirësim i disa ekzistueseve.

*Problematikat e paraqitura nga AKU:* Mungesa e rregullores së brendshme, pasi rregullorja aktuale nuk reflekton ndryshimet strukturore që ka pësuar AKU; mungesa infrastrukturore, të cilat komprometojnë drejtpërsëdrejti procesin e kontrollit dhe marrjes së mostrave ndaj subjekteve, qofshin importues apo prodhim vendas, mungesa të ambienteve karantinore dhe frigoriferike në Pikat e Inspektimit Kufitar, si dhe mungesa të theksuara të pajisjeve laboratorike dhe pajisjeve për marrjen, transportin dhe karantinimin e mostrës; Inspektorët e AKU, në disa DRAKU nuk përdoren tabletat e inspektimit dhe inspektimet kryhen në kite inspektimi, të cilat nuk mundësojnë gjurmueshmërinë e procedurës inspektuese; informaliteti i lartë në ekonominë tonë, fenomen i cili sjell si pasojë jo vetëm evazion fiskal dhe cenim të rëndë të sigurisë së ushqimit, por në të njëjtën kohë frenon investimet e OBU-ve për rritje të standardeve të sigurisë ushqimore; mosfunksionimi i Komitetit dhe paneleve shkencore, organe të cilat përbëhen nga ekspertë të jashtëm me kualifikim të lartë akademik, por që nuk janë pjesë e organikës së AKU dhe për rrjedhojë ky kontribut i tyre, njëlloj si për të gjitha organet e tjera kolegjiale, kërkon një pagesë të caktuar.

*Problematikat e evidentuara për AKU:* Miratimi i rregullores së brendshme; vijon të kryhet me dy standarde plani i marrjes së mostrave; ka mungesë të realizimit të planit të marrjes së mostrave me 1025 mostra më pak se plani; nuk kryhet në formë periodike dokumentimi i plotë i parregullsisve gjatë procesit të inspektimit për përmbushjen e kërkesave të ligjit specifik, por edhe të zbatimit rigoroz të procedurës së inspektimit, për vlefshmërinë ligjore të veprimeve administrative nga trupat inspektuese; ka mangësi në plotësimin e saktë të listave të verifikimit dhe procesverbalit; të ngarkojnë në dosjen elektronike të inspektimit, autorizimin e inspektimit me firmën dhe vulën e K/inspektorit, dokumentacionin e plotë të aplikimit për licencë të OBU, si dhe dokumentet dhe pamjet që vërtetojnë se OBU i plotëson apo jo, kushtet; nuk ka marrë masa për hartimin e listave të verifikimit për asgjësimin dhe për procedurat e licencimit; procedurat e licencimit kryen pa njoftim paraprak, ndërkohë që nuk ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit; trupat e inspektimit të AKU duhet të fillojnë kryerjen e vlerësimit të riskut në përfundim të procesit të inspektimit, në bashkëpunim me IQ, për të tre fushat e inspektimit, si dhe kontrollin në PIK-e; Sektori juridik dhe Sektori i

burimeve njerëzore, sipas roleve dhe detyrimeve ligjore të zbatojnë përgjegjësitë e përcaktuara për përdorimin e sistemit “*e-Inspektimi*”.

*Spektori i PIK:* Të marrë masa që veprimtaria inspektuese në PIK, të kryhet online në sistemin “*e-Inspektimi*”, me dokumente standarde, listë-verifikimi dhe kartën digjitale të inspektorit, bazuar në metodologjinë e analizës së vlerësimit të riskut; duhet të jetë bashkëpunues me organet mbikëqyrëse dhe të kërkojë ndihmë të specializuar nga sektorët përkatës për interpretimin e akteve ligjore dhe më pas zbatimin në formë profesionale, të detyrimeve që rrjedhin nga ligji; Spektori i PIK, në DPAKU, duhet të mbikëqyrë praktika të kontrollit zyrtar në PIK-e, të realizuara në zhdoganim, me qëllim decentralizimin e përgjegjësive për zbatueshmërinë e akteve ligjore në fuqi dhe përmirësimin e sigurisë ushqimore në vend; sektori duhet të aplikojë metodologji të vlerësimit të riskut, për inspektorin e PIK, për Pikën Kufitare, si dhe për subjektin dhe ta paraqesë atë në “Planin Kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe i marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe plani i marrjes së mostrave në PIK”; të mbledhë informacion, ta shqyrtojë dhe analizojë, për të krijuar një plan veprimi, për strategjinë e menaxhimit të riskut, nën një ekuilibër të duhur ndërmjet lehtësisë të tregtisë dhe kontrollit doganor, për garantimin e sigurisë ushqimore; të paraqesë më shumë vullnet për zbatimin e objektivit të ndërmarrë në Raportin e Aktivitetit Vjetor, për realizimin e kontrollit zyrtar të PIK, në sistemin online “*e-Inspektimi*”; AKU të marrë masa për garantimin e sigurisë ushqimore, për produktet e import/tranzitit dhe eksportit, duke qenë se Spektori i PIK në DPAKU është e vetmja strukturë përgjegjëse për këtë qëllim; AKU nuk parashikon tek objektivat e saj për vitin 2022, kryerjen e inspektimeve në PIK në sistemin online “*e-Inspektimi*”.

*Objektivat:* Hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme; rishikimi dhe miratimi i manualeve të procedurave standarde të inspektimit (SOP); përmirësimi i Planit vjetor të inspektimeve me bazë risku, duke përfshirë përveç elementeve të tjerë edhe historikun e çdo OBU; draftimi dhe lançimi i Fushatës Digjitale të Edukimit mbi Sigurinë Ushqimore; ndërgjegjësimin e OBU për zbatimin e kërkesave ligjore, nëpërmjet këshillimit dhe organizimit të trajnimeve me tematika specifike kryesisht në fushën e implementimit të sistemit të vetëkontrollit HACCP dhe sistemit të gjurmueshmërisë; vënia në eficiencë të plotë e mekanizmit të kontrollit të brendshëm; identifikimi i kërkesave dhe nevojave adekuate për trajnimin e inspektorëve të DPAKU nga secili sektor i DP, si dhe përgatitja e moduleve përkatëse të trajnimit; përgatitja e një moduli trajnimi (pocket book) për kontrollin e gjurmueshmërisë së produkteve, ku të ketë raste specifike për produkte apo grup produktesh të caktuara, pasi mosfunksionimi i gjurmueshmërisë cenon rëndë sigurinë ushqimore; pajisja e grupeve të inspektimit me mjetet e marrjes, transportit dhe garantimit të mostrës; përgatitja e kërkesave për akreditim dhe dërgimi i tyre pranë DPA për njohjen e procedurës për akreditim; draftimi i metodologjisë për vendosjen e masave administrative “gjobë”, referuar rëndësisë dhe frekuencës së përsëritjes së shkeljes; rritja e cilësisë së inspektimeve nëpërmjet përditësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të listave të verifikimit; identifikimi i rreziqeve potenciale fiziko-kimike dhe adresimi i saktë i tyre tek panelet shkencore.

## **6.2.Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA)**

Drejtoria e Shërbimeve të peshkimit dhe Akuakulturës, Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit, ka për mision kontrollin në ujë apo në tokë, për respektimin rregullsisë së zënieve që ndodhen në bordin e mjetit lundrues të peshkimit, të magazinuara, të transportuara, në përpunim apo të tregtuara, si dhe vërtetësinë dhe saktësinë e dokumenteve apo transmetimeve elektronike që lidhen me to, nëpërmjet aktiviteteve inspektuese sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Në zbatim të VKM-së nr.719 datë 20.10.2011, "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Mëdhes dhe Peshkimit, Sarandë", i ndryshuar, fushat e përgjegjësisë së DSHPA janë: (a) rregullsia e veglave të peshkimit të përdorura për llojet, objekt kontrolli dhe për zëniet e tyre që janë në bordin e anijes së peshkimit; (b) nëse është e përshtatshme, planin e ngarkesës dhe ngarkesat e veçanta të llojeve; (c) shënjimin e veglave të peshkimit; (ç) informacionin përkatës për motorin, ashtu siç parashikohet në këtë ligj. (d) Kontrolli kryhet në ujëra apo në tokë, përfshirë portet, pikat e zbarkimit, mjetet e transportit, qendrat e grumbullimit të peshkut, merkatot, pikat e shitjes dhe restorantet.

DSHPA, ka realizuar gjithsej 1521 inspektime, nga të cilat 1011 brenda programit të inspektimit dhe 510 jashtë programit të inspektimit. Janë marrë 86 masa administrative "Gjobë" me një vlerë prej 8 887 000 lekë dhe janë arkëtuar 525 000 Lekë.

Inspektimi në vijën bregdetare: është realizuar për monitorimin e vijës bregdetare në lidhje me parandalimin dhe evidentimin e gjuetisë së paligjshme; organizime i kontrolleve të befasishme në zonat bregdetare dhe në Portet e peshkimit; sensibilizim dhe ndëshkim i anijeve të peshkimit për mos plotësimin e librave të zënies; marrja e masa administrative, si dhe bllokim i akcizës së karburantit ndaj subjekteve të cilët nuk kanë dorëzuar të dhënat; bllokuar deri në pajisjen me licencë mjetet e peshkimit, të cilat kryejnë aktivitet peshkimi artizanal të paligjshëm dhe të pa pajisura me licencë; në bashkëpunim me Policinë e Kufirit dhe Migracionit për verifikimin e të gjitha varkave, të cilat ushtrojnë aktivitet peshkimi artizanal të pa pajisur me licencë.

Inspektimi në det janë kryer: për evidentimin e gjuetisë së paligjshme, duke organizuar inspektime në zonat më problematike dhe këto kontrolle të befasishme kanë qenë efektive, por vendosja në efikasitet të plotë të sistemit VMS (Vessel Monitoring System) SVA (Sistemi i Vëzhgimit të Anijeve) në muajin Maj 2021, ka dhënë rezultate në evidentimin e gjuetisë së paligjshme ku janë marrë masa administrative ndaj çdo mjeti, i cili është konstatuar nën thellësinë apo distancën e pa lejuar, duke sjellë sensibilizim për ruajtjen e distancës nga bregu dhe thellësinë e lejuar nga të gjitha anijet e peshkimit; patrullimin e përbashkët, në orët e vona të natës, me Policinë e Kufirit dhe Migracionit dhe Rojën Bregdetare në koordinim të ngushtë me QNOD, mbi evidentimin dhe parandalimin e gjuetisë së paligjshme, në parandalimin dhe evidentimin e gjuetisë nënujore mbi zënie e specieve të ndaluara apo pa pajisur me licencë.

Inspektim për evidentimin dhe parandalimin në ujëra të brendshëm: Gjatë kontrolleve të ushtruara në liqene janë marrë masa për evidentimin dhe parandalimin e gjuetisë së paligjshme në bashkëpunim edhe me OMP.

Në liqenin e Ohrit, në zbatim të urdhrimit të ministrit për ndalimin e gjuetisë së Koranit, nëpërmjet njësisë Task – Forcë u parandalua gjuetia e paligjshme, si dhe në zonat Tushemisht, Piskupat, Lin dhe Udenisht e liqenin e Prespës, të cilat janë pikat më problematike për gjuetinë e Krapit dhe janë vendosur masa administrative.

Në liqenin e Shkodrës është ushtruar kontroll në pikat e tregtimit të produkteve peshkore në bashkëpunim me AKU – Shkodër, për tregtimin e Krapit. Në tregjet e peshkut është bërë e mundur pajisja me certifikatë origjine. Kontrollat janë ushtruar edhe në lagunat e Vainit, Merxhanit, Patokut, Vilunit, Karavastasë, Nartës dhe Butrintit. Gjithashtu, janë kryer kontrollat në liqenin e Prespës; në liqenet Ulëz, dhe Shkopet, në bashkëpunim me OMP, janë ushtruar kontrollat në orët e vona të natës, si dhe në orët e para të mëngjesit ku ka patur dyshime për aktivitetet peshkimi të paligjshëm, falë kontrolleve të ushtruara sistematikisht nuk janë konstatuar shkelje të ligjshmërisë së peshkimit; në Liqenin e Fierzës, janë kryer kontrollat në zbatim të urdhrimit të ministrit për ndalimin e gjuetisë së krapit në këtë liqen.

Inspektimi në pikat e tregtimit dhe magazinimit të produkteve peshkore: janë kryer kontrollat në pikat e tregtimit të produkteve peshkore dhe sensibilizimin e subjekteve për tregtimin e llojeve të ndaluara “Dater”, si dhe janë njoftuar subjektet e hapura këtë vit për masat mbi tregtimin e specieve të ndaluara, si pasojë e këtyre masave të marra është ulur ndjeshëm numri i restoranteve të cilat e tregtojnë atë. Gjithashtu, janë organizuar grupe inspektuese të përbashkëta me AKU kundër tregtimit informal të produkteve peshkore dhe janë ndëshkuar kundërvajtësit.

Inspektim Akuakulturë: Në subjektet e Akuakulturës detare dhe ujërave të ëmbël, janë ushtruar mbi zbatimin e ligjshmërisë në këtë fushë; zbatimin e pikave të kontratës si specieve të autorizuara për kultivim ku nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore; kryerja e detyrës së agjentit tatimor, me urdhër ministri.

Arritjet: Kryen inspektime on-line nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”, me dokumente standarde; ka kryer vlerësimet e listave të verifikimit për krijimin e databazës së analizës së riskut dhe funksionimin e metodologjisë së riskut në efikasitetin e punës së këtij sektori; ka implementuar 4 lista verifikimi të reja në përputhje me ndryshimet ligjore; organizimi i gjuetisë bregdetare nëpërmjet OMP-ve, praktikë kjo e cila ka rezultuar e suksesshme në liqenin e Shkodrës dhe Pogradecit.

Problematikat: Nuk përdor tabletën gjatë inspektimit, gjë e cila bën të pamundur gjurmimin e vendit të kryerjes së inspektimit; mungesë logjistike, si mjete lundruese dhe ato të transportit; mungesa e stafit ku është kërkuar shtimi i strukturës sidomos për strukturën e porteve; mungesa e dokumentacioneve nga ana e mjeteve të vogla (sanalle) e bën të pamundur aplikimin për pajisje me licencë peshkimi.

Objektivat: Implementimi i plotë i analizës së riskut në planifikimin e veprimtarisë inspektuese; parandalimin dhe evidentimin e gjuetisë së paligjshme; fushata sensibilizuese për subjektet në drejtim të njohjes nga ana e tyre për ndërgjegjësimin mbi tregtimin e specieve të ndaluara dhe njohja me Ligjin e Peshkimit; fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në mbrojtjen e

hapësirës detare dhe ujërave të brendshëm; fuqizimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve, seminareve, workshopeve.

## **7. MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

### **7.1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)**

ISHSH, është autoriteti përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë së shëndetësisë.

Në zbatim të VKM nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror shëndetësor”, ISHSH në nivel qendror planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit; siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi; bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve dhe siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të akredituar; informon publikun për veprimtarinë e inspektimit; jep mbështetje teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit; përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit si dhe kryen drejtpërdrejt inspektime ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë. Degët rajonale të ISHSH-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin.

ISHSH, është institucioni kryesor i ngarkuar për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, masa të cilat rrjedhin prej Ligjit 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Gjatë 2021, janë realizuar 329256 monitorime në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, rezulton se ISHSH, gjatë vitit 2021, ka realizuar 24254 inspektime, nga të cilat 15958 (66%) janë të programuara dhe 8296 jashtë programi (34 %), si dhe janë pajisur me Akt-Miratimi Higjieno-Sanitar 1688 subjekte.

Janë marrë 112 masa administrative gjobë, nga të cilat 72 % janë marrë në inspektime të realizuara jashtë programi.

Gjatë vitit 2021, pranë ISHSH Qendror janë zhvilluar 6 Komisione të Ankimit Administrative të Trupës Kolegjiale të ISHSH, ku janë shqyrtuar 58 masa administrative, nga të cilat 54 masa janë lëna në fuqi dhe vetëm 4 janë anuluar (6.9 %).

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë janë realizuar 83 procese gjyqësore, nga të cilat 34 janë fituar, 24 humbur dhe 4 procese gjyqësore në procedurë Apeli Administrativ.

Janë lëshuar 164 Vendime Lëshimi Urdhër Ekzekutimi për masa administrative të viteve 2015-2021 dhe 123 Vendime Lëshimi Urdhër Ekzekutimi janë në proces, si dhe janë ekzekutuar 138 masa gjithsej me vlerë 34 953143 lekë. Nga masat e marra në vitin 2021 janë arkëtuar 10 masa në vlerën totale 610 000 lekë.

*Arritjet:* ISHSH, realizon procedurën e inspektimit online, me dokumente standarde dhe listë-verifikimi; edhe në vitin 2021, përveç detyrave funksionale, trupa inspektuese e ISHSH ka kryer kontrole të vazhdueshme për zbatimin e protokolleve të masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19; evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatimi i rregulloreve në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit të kujdesit shëndetësorë parësorë publik; evidentimi i llojeve të ndryshme të produkteve kozmetike me qëllim rritjen e regjistrimit të produkteve kozmetike; evidentimi i derdhjeve të ujërave të zeza në zonat turistike dhe kushteve higjieno-sanitare të subjekteve akomoduese me qëllim shmangien e ngjarjeve të padëshiruara në shëndetin e popullatës; inspektimi i subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm duke arritur në vetëm 1 rast të shpërthimit të sëmundjeve me origjinë hidrike; bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake për ndalimin e tregtimit të ujit të pijshëm në mënyrë të jashtëligjshme dhe në kushte jo të mira higjieno-sanitare;

*Problematikat:* Në disa raste ka pasaktësi në mbajtjen e dokumentacionit të inspektimit dhe procedura nuk realizohet me tabletë; dosja e inspektimit nuk dokumentohet me njoftimin e autorizimit, njoftimin e procesverbalit, dokumentacion shoqëruar për gjetjet e konstatuara apo kur inspektimi është jashtë programi, si dhe ka mospërputhje midis kohëzgjatjes së inspektimit të deklaruar në dokumentacionin e mbajtur dhe nga gjurmimi në sistem; në disa raste shtyrja e autorizimit dhe inspektimi në kushtet e flagrancës nuk realizohet në përputhje me kërkesat ligjore; ka raste ku procedura e inspektimit është mbajtur jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizimi dhe vendimi përfundimtarë i inspektimit nuk është marrë në përputhje me parashikimet ligjore; në modulën “Gjobat”, nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti) nga personi përgjegjës.

*Objektivat:* Zbatimi i masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19; plotësimi i standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitetet që ofrohen në shërbimin spitalor në kuadër të Reformës së Autonomisë Spitalore; plotësimi i standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitetet që ofrohen në shërbimin parësorë; në bazë të indikatorëve të riskut të shëndetit publik dhe riskut sipas historikut, në shërbimet e kujdesit spitalorë dhe parësorë publik; të veprimtarisë dhe licencimit për kryerjen e procedurës së marrjes dhe analizimit të mostrave RT-PCR dhe test antigen SARS COV-2 në laboratorët mjekësorë; përditësimi i procedurës së lëshimit të Akt-Miratimit Higjieno-Sanitarë në kuadër të digjitalizimit të tij; evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi, për sigurimin e kushteve optimale të mësimin dhe jetesës në institucionet arsimore parashkollore jopublike; për ndjekjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga produktet e duhanit etj.

## ***7.2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)***

AKBPM është institucioni i specializuar për analizën dhe kontrollin e barnave, për dhënien e autorizimit për tregtim, për inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike, për farmakovigjilencën dhe për administrimin e standardeve të pajisjeve mjekësore.

Ndër funksionet e AKBPM është inspektimi i barnave pranë subjekteve farmaceutike, të cilat kanë të bëjnë me vendosjen në treg, tregtimin me shumicë dhe pakicë, kushtet e ruajtjes së

barnave, lëndëve të para dhe ndihmëse e materialeve ambalazhuese, tregtimin dhe eksportimin e barnave të prodhuara nga fabrikuesit vendas, importin e barnave, autorizimin për import, si dhe pajisjeve mjekësore. Ky institucion e ushtron veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, ligjit nr. 89/2014, “Për Pajisjet Mjekësore”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 24, datë 14.01.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, e ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

AKBPM, ka gjithsej 99 punonjës, ku sektori i inspektimit ka 21 punonjës nga të cilët 20 inspektorë dhe 1 shef sektori, përgjegjës për inspektimin në fushën farmaceutike për barna dhe pajisje mjekësore.

Nga mbikëqyrja e realizuar, online, nëpërmjet portalit të inspektimit “*e-Inspektimi*”, rezulton se AKBPM, gjatë vitit 2021, ka realizuar 664 inspektime, nga të cilat 452 (68%) janë të programuara dhe 208 jashtë programi (32 %), si dhe janë marrë 79 masa administrative gjobë, nga të cilat 39 janë marrë në inspektime të programuara dhe 40 në inspektime jashtë programi (50.6 %).

Pranë komisionit të ankimit janë bërë 13 ankime administrative, nga të cilat 12 janë lënë në fuqi dhe 1 është shfuqizuar.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë janë shqyrtuar 16 çështje:

- 12 çështje kanë përfunduar, nga të cilat 9 janë fituar duke lënë në fuqi vendimin e inspektorëve dhe 3 janë shfuqizuar;
- 4 çështje janë akoma në proces.

Për vitin 2021, nga 79 masa administrative janë ekzekutuar 40, pra nga 10 850 000 lekë janë arkëtuar gjithsej 4 318 000 lekë.

*Arritjet:* Nga mbikëqyrja rezulton se, përgjithësisht, procedura e inspektimit realizohet në përputhje me ligjin për inspektimin, ligjin e posaçëm, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, online nëpërmjet tabletës.

*Problematikat:* Ka pasaktësi në plotësim të dokumentacionit dhe dosja nuk dokumentohet me dokumentacion shoqërues. Në shumë raste, në inspektimet e programuara në depo farmaceutike apo të pajisjeve mjekësore, inspektimi nuk realizohet, me argumentimin se subjekti gjendet i mbyllur apo nuk gjendet në adresën e deklaruar në QKB. Në modulën “Gjobat”, nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti) nga personi përgjegjës.

*Objektivat:* Fokusimi në kontrollin dhe inspektimin e pajisjeve mjekësore që vendosen në treg, për përmirësimin e nivelit të mbrojtjes dhe sigurisë së shëndetit të pacientëve apo përdoruesve të tyre, në përputhje me nivelet e efektshmërisë së pajisjeve mjekësore të siguruar nga prodhuesit; sigurimi dhe ruajtja e cilësisë së barnave në treg; rritja e disponueshmërinë; ofrimi i shërbimit cilësor farmaceutik të disponueshëm në të gjithë territorin, si dhe të zbatimit të “Planit Vjetor 2022” të miratuar.

### *7.3.Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR)*

ZMR ka mision kryesor përcaktimin e kushteve të mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar në maksimum të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese, si dhe monitorimin e rrezatimeve jojonizuese.

ZMR, gjatë vitit 2021, ka realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private, që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X dhe në ato qendra ku aplikohet veprimtari me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive, si dhe matje në lidhje me fuqinë e dozës, në ambientet publike dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues. Në bazë të këtyre matjeve është përcaktuar doza efektive vjetore për publikun dhe stafin.

Veprimtaria inspektuese e saj është realizuar në funksion të kërkesave të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, si dhe organizohet në nivel qendror në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

ZMR, në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2021, ka planifikuar 71 inspektime dhe ka realizuar po 71 inspektime, të cilat janë të gjitha inspektime të planifikuara. Gjithashtu, janë marrë 24 masa administrative kryesore, nga të cilat 7 heqje licence dhe 17 paralajmërime, si dhe nuk është ankimuar asnjë nga masat administrative, që kanë marrë inspektorët e ZMR.

*Arritjet:* ZMR realizon të gjithë veprimtarinë inspektuese online, me tabletë, konform ligjit për inspektimin, nëpërmjet dokumentacionit standard, mbështetur në programin vjetor dhe programet mujore; realizon njoftimin paraprak të subjekteve që do të inspektohen brenda afateve të përcaktuara me ligj, si dhe ky njoftim bashkëlidhet në sistemin “e-Inspektimi”; është dakordësuar që inspektimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari pa licencë do të kryhet nga inspektorët e ZMR, pas analizimit nga ana juridike, diskutimeve me përfaqësues ligjorë të ISHSH dhe MSHMS;

*Problematikat:* Gjatë mbikëqyrjes online të veprimtarisë inspektuese për ZMR, u konstatua se trupa inspektuese e ZMR, vazhdon të mos kryejë inspektime për sa i përket zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jojonizues; procedura inspektuese duhet të dokumentohet me dokumente justifikuese, të cilat duhet të ngarkohen në sistemin “e-Inspektimi”.

*Objektivat:* Për vitin 2022, në bazë të programit vjetor të inspektimit është planifikuar kryerja e inspektimeve në 85 subjekte private dhe shtetërore në të gjithë vendin, ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të kryhen online dhe me tableta, sipas ligjit dhe rregullave të caktuara për veprimtarinë inspektuese.

## 8 *MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT*

### *8.1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)*

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ushtron inspektime duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

AKM, ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore. AKM, ushtron kontrole për verifikimin e kërkesave ligjore në fushën e mjedisit dhe ujërave. AKM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në 2 nivele: nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM).

Trupa inspektuese e AKM-së, ka në përbërje 101 inspektorë, në nivel qendror 25 inspektorë, ARM-Tiranë 25 inspektorë, ARM Berat 20 inspektorë, ARM Fier 18 inspektorë dhe ARM Lezhë 13 inspektorë .

AKM, për periudhën Janar-Maj 2021, nuk ka ushtruar aktivitet inspektues për shkak të Pandemisë Covid-19. Sektori i Inspektimit Mjedisor, Qendër, në mbështetje të Urdhrit nr. 156, datë 10.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, si dhe Urdhrit nr. 28, datë 21.10.2020, “Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadër të Task Forcës Anti Covid-19”, ka ngritur 9 grupe pune të përbërë nga 2-3 inspektorë për grup, për zbatimin e masave të sigurisë dhe sensibilizimin e qytetarëve për mbajtjen e barrierave mbrojtëse (maskat).

Nga mbikëqyrja rezulton se për periudhën Qershor-Dhjetor 2021, AKM ka realizuar 1308 inspektime gjithsej, ku nga këto 1145 të programuara dhe 163 jashtë programit, të ndara sipas rajoneve sa më poshtë:

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme-204 inspektime të programuara dhe 25 inspektime jashtë programit;
- ✓ ARM-Lezhë - 255 inspektime të programuara dhe 11 inspektime jashtë programit;
- ✓ ARM-Tiranë - 170 inspektime të programuara dhe 104 inspektime jashtë programit;
- ✓ ARM-Fier - 282 inspektime të programuara dhe 12 inspektime jashtë programit;
- ✓ ARM-Berat - 234 inspektime të programuara dhe 11 inspektime jashtë programit.

Trupa inspektuese, gjatë vitit 2021, ka marrë gjithsej 123 masa administrative, nga të cilat 94 gjoba dhe 29 paralajmërime. Vlera në lekë e të gjitha masave (gjobave) të vendosura është 633 780 000 Lekë.

Për vitin 2021, pranë Sektorit të Ankimimeve, Apelim, Ekzekutim, Trajtim të Penaliteteve, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, janë depozituar dhe shqyrtuar 46 ankime administrative, nga të cilat:

- ✓ 8 masa administrative (gjobë) janë rrëzuar;
- ✓ 37 masa administrative (gjobë) janë lënë në fuqi.

Në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, janë 17 masa administrative të ankimuara, për 14 masa është bërë kërkesë për lëshim Urdhër ekzekutimi drejtuar Gjykatës, 3 gjoba janë paguar vullnetarisht nga subjekti dhe 1 është ekzekutuar nga përmbarimi.

*Arritjet:* Veprimtaria inspektuese realizohet online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, të programuara, me njoftim, nëpërmjet dokumentacionit standard; pjesëmarrja në një Task Force Rajonale të fokusuar në gjetjen e subjekteve me pa përputhshmëri; krijimi i një lidhje telefonike për raportimin e parregullsive, të mashtrimeve dhe incidenteve; trajnimi i inspektorëve për të rritur kapacitetet profesionale të inspektorëve; raportimi i informacionit për veprimtarinë e inspektuese në bazë të të dhënave nga sistemi unik; reduktimi i numrit të ditëve të inspektimit, si pasojë e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku.

*Problematikat:* Lidhur me veprimtarinë online të inspektimit, ka pasaktësi në shtyrjen e kohëzgjatjes së inspektimit, duke e shtyrë për një periudhë më të madhe se kohëzgjatja fillestare. Gjithashtu, ka raste kur dokumentet standarde të inspektimit nuk plotësohen në tërësinë e tyre dhe mbahen jashtë afateve të përcaktuara në Autorizimin e Inspektimit; Mungesa e një regjistri elektronik të subjekteve aktive të pajisura me Leje Mjedisi; Nevoja për përmirësimin e listë verifikimeve; Numër shumë i madh subjektësh që ushtrojnë aktivitet pa qenë të pajisur me leje/autorizim nga organet e menaxhimit të burimeve ujore; Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet: Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Zyrave të Administrimit të Burimeve Ujore, Bashkive, Policisë dhe trupave inspektuese, me qëllim: identifikimin, regjistrimin dhe detyrimin e subjekteve që të aplikojnë dhe pajisen me leje të Autoriteteve të Ujit; Nevoja për trajnimin e inspektorëve të rinj për përdorimin e sistemit online “*e-Inspektimi*”; Mungesë logjistike (zyra për inspektorët; baza materiale; automjete).

*Objektivat:* Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me procesin e VNM-ve; Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji; Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe biodiversitetit; Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike; Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj; Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit; Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut; Ndërgjegjësimi i publikut në vendimmarrjen mjedisore; Thjeshtimi i procedurave për biznesin; Thjeshtimi i procedurave dhe shkurtimi i afateve për shqyrtimin dhe dhënien e vendimit; Krijimi i një baze të dhënash (regjistër elektronik) për të gjitha procedurat e kryera dhe dhëniet e vendimeve përkatëse.

## **8.2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB)**

AKB synon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet, që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke inspektuar mjediset dhe dokumentacionin e subjekteve, që ushtrojnë veprimtari turistike, si dhe duke monitoruar

rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare, në kuadër të respektimit të rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare.

AKB ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM nr. 568, datë 17.07.2019, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore, në territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

Trupa inspektuese e AKB, në nivel qendror në përbërje ka 19 inspektorë, ndërsa në 4 rajonet ka nga 1 specialist, të cilët nuk kryejnë inspektime.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021, AKB, Drejtoria Qendrore ka realizuar 50 inspektime gjithsej (me status të mbyllur), për inspektimin e pajisjes me kontratë dhe kushteve e kriterëve të stacioneve të plazhit, ku prej të cilave:

- ✓ 13 inspektime me masë administrative “gjobë”;
- ✓ 27 inspektime me masë administrative “paralajmërim”;
- ✓ 10 inspektime pa masë administrative.

Gjithashtu, AKB-DQ ka kryer 1 774 kontrole, nga të cilat 833 me karakter informues dhe 941 monitorime në strukturat akomoduese, agjencitë e udhëtimit, agroturizëm, stacionet e plazhit, dhe udhërrëfyesit turistik.

Trupa inspektuese, gjatë vitit 2021, ka marrë gjithsej 40 masa administrative, nga të cilat 13 gjoba dhe 27 paralajmërimë. Vlera në lekë e të gjitha masave të vendosura është 2 600 000 lekë.

Për vitin 2021, pranë Komisionit të Ankimit në AKB, janë depozituar dhe shqyrtuar 4 ankime administrative, nga të cilat:

- ✓ 2 masa administrative “gjobë” janë rrëzuar;
- ✓ 2 masa administrative “gjobë” janë lënë në fuqi.

Nga masat administrative të lëna në fuqi nga Komisioni i Ankimit, 1 vendim administrativ është ankimuar pranë gjykatës dhe është në proces gjyqësor.

*Arritjet:* Kryerja e inspektimeve online, me tabletë, me dokumentacionin standard, të nënshkruar elektronikisht, konform ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale në fuqi; ndikimi në rritjen e zbatueshmërisë së kriterëve ligjore gjatë ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari turistike, si stacionet e plazhit, strukturat akomoduese, nëpërmjet inspektimeve e monitorimeve të kryera; bërja e evidente e inspektoratit si një institucion që ka në fokus kontrollin e respektimit të kriterëve ligjore për subjektet që ushtrojnë veprimtari pritëse si “agroturizëm”; dhënia e kontributit në nxitjen e strukturave akomoduese për t’u pajisur me certifikatë kategorizimi nëpërmjet monitorimit dhe verifikimit në terren; ndërgjegjësimi i subjekteve që ushtrojnë aktivitet si agjenci udhëtimi nëpërmjet

monitorimeve me karakter informues të subjekteve me aktivitet agjenci udhëtimi, lidhur me respektimin e kërkesave ligjore, për të ofruar shërbime turistike cilësore.

*Problematikat:* Lidhur me veprimtarinë online të inspektimit, AKB nuk realizon inspektime të programuara dhe me njoftim paraprak; ka pasaktësi dhe mangësi në plotësimin e akteve administrative në tërësinë e tyre; mos përcaktimi i qartë i kompetencave për zbatimin e ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, në mënyrë që të inspektohet zbatueshmëria e kërkesave ligjore dhe të merren masat e përcaktuara në këtë ligj; kuadri ligjor jo i plotë në fushën e turizmit; mungesë bashkëpunimi ndërinstytucional, në mënyrë të veçantë në drejtim të shkëmbimit të informacionit, i cili është i nevojshëm për mbarëvajtjen e punës së AKB dhe kjo është shumë evidente në komunikimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore; vështirësitë e subjekteve në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara sipas fushave specifike, si pasojë e mos njohjes së mjaftueshme të këtyre detyrimeve; mungesa e automjeteve për inspektim, e cila sjell vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve, duke pasur në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale.

*Objektivat:* Kryerja e inspektimeve për kontrollin e kriterëve ligjore nga subjektet, në lidhje me fushat që janë në fokusin e punës së drejtorisë; hartimi i listë-verifikimeve për kërkesat ligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”; mbarëvajtja e sezonit turistik nëpërmjet kontrollit të zbatimit të kushteve dhe kriterëve në stacionet e plazhit, përgjatë gjithë zonave bregujore; hartimi i metodologjisë së riskut për subjektet, që veprojnë në fushën e agjencive dhe operatorëve turistikë, strukturave akomoduese, udhërrëfyesve turistikë dhe stacioneve të plazhit, duke u nisur nga rezultatet e inspektimeve të mëparshme dhe përfshirja e tyre në planin e punës për 2022.

## **VII Raportimi i veprimtarisë për inspektoratet vendore**

Në bazë të detyrimeve të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati Qendror, edhe gjatë vitit 2021, vazhdoi punën për të përfshirë në sistemin “*e-Inspektimi*”, edhe për 42 njësi të qeverisjes vendore.

Për këtë IQ, vazhdoi zbatimin e planit të punës lidhur me fazat e implementimit të inspektorateve vendore në sistemin “*e-Inspektimi*”. Inspektorati Qendror në bashkëpunim me 42 bashkitë, identifikuan funksionet e inspektimit që mbulonte çdo bashki, sipas ligjit të qeverisjes vendore nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Për këtë, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore janë hartuar listat e verifikimit dhe përshtatur dokumente standarde të inspektimit, të cilat kanë kaluar për implementim në sistemin “*e-Inspektimi*”.

Inspektorati Qendror ka trajnuar 40-inspektorë të bashkisë Lezhë, trajnim i cili u zhvillua sipas një kurrikule trajnimit për njohjen me kuadrin ligjor për inspektimin, si dhe për kryerjen e inspektimeve online nga sistemi elektronik “*e-Inspektimi*”.

Gjithashtu, IQ mban dhe përditëson Regjistrin e Inspektorëve vendor në detyrë, me të gjitha funksionet inspektuese për secilën Bashki.

### VIII. Raport Monitorimi i Buxhetit për vitin 2021 për Inspektoratin Qendror

Në zbatim të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Inspektoratit Qendror është miratuar plani i buxhetit prej 43 200 000 leke, i detajuar si më poshtë vijon:

*Në Lekë*

Llog.ekonomike	përshkrimi	Plan 2021
llog. 600	Paga	25 000 000
llog. 601	Sig.shoq punëdhënësi	4 100 000
llog. 602	Shpenzime operative	11 000 000
llog. 606	Ndihma ekonomike	100 000
llog. 231	Shpenzime kapitale	3 000 000
	<b>TOTALI</b>	<b>43 200 000</b>

Për vitin 2021, Inspektorati Qendror ka realizuar buxhetin në vlerën **37 778 425 Lekë**, nga totali i akorduar prej **43 200 000 Lekë** ose **87.45 %** të fondit të planifikuar vjetor 2021. Diferenca e fondit të planifikuar me fondin e realizuar është sipas tabelës më poshtë:

*Në Lekë*

Llog.ekonomike	përshkrimi	Buxheti Vjetor Plan i Viti 2021	Fakti i vitit progresiv 2021	Realizimi buxhetor 2021 (%)
llog. 600	Paga	25 000 000	20,646,421	82.58%
llog. 601	Sig.shoq punëdhënësi	4 100 000	3 316 585	80.90%
llog. 602	Shpenzime operative	10 950 000	10 665 419	97.38%
llog. 606	Ndihma ekonomike	150 000	150 000	100%
llog. 231	Shpenzime kapitale	3 000 000	3 000 000	100%
	<b>TOTALI</b>	<b>43 200 000</b>	<b>37 778 425</b>	<b>87.45%</b>

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore** (zëri 600-601) është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me VKM nr. 24, datë 03.03.2017 me 21 punonjës.

Për vitin 2021, deri tani numri i punonjësve është 20 punonjës faktik, sipas strukturës.

**Fondi për shpenzime kapitale (zëri 231), me financim të brendshëm.**

Për vitin 2021, plani i buxhetit për shpenzime kapitale me financim të brendshëm është akorduar në vlerën **3 000 000 Lekë**, për “Blerje Tableta dhe zhvillimi i tyre në sistem”, si dhe “Blerje kompjutera për zyrat e IQ-së dhe pajisje mbrojtëse për serverin”, të cilat do të prokuroheshin nga AKSHI, gjë e cila nuk u realizua. Për këtë fond, meqenëse Inspektorati Qendror ka detyrime të prapambetura për shërbim, zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemit “*e-Inspektimi*” (i cili tani ka kaluar në pronësi të AKSHI-t), kërkoi rialokim fondi, ku nëpërmjet shkresës me nr.17144/1 prot., datë 22.10.202, u konfirmua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndërkohë u realizuan me 100% shlyerja e detyrimeve të prapambetura.

Në realizimin e zërave buxhetorë të planifikuar për Vitin 2021, Inspektorati Qendror ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe dispozitat administrativo-financiare të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”.

## IX KONKLUZIONE

Inspektorati Qendror, bazuar në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe në analizën në tërësi të komponentëve të veprimtarisë inspektuese, konkludon se procesi inspektues është përmirësuar duke bërë të mundur kryerjen e inspektimeve online, me dokumente të standardizuara, pranë dhe në prani të biznesit, duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Për sa më sipër në këtë raport konkludojmë se:

- ✓ Inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese përgjithësisht realizojnë veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, ligjeve sektoriale, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.
- ✓ Veprimtaria inspektuese në disa prej inspektorateve shtetërore realizohet nëpërmjet kiteve portabel dhe jo tabletave, gjë e cila e bën të pamundur verifikimin nëse dokumentacioni inspektues është mbajtur pranë dhe në prani të subjektit, në zbatim të pikës 2, të nenit 45, të ligjit për inspektimin.
- ✓ Për kontrollin e zbatimit të masave anti – Covid, Inspektorati Qendror ushtroi rolin e tij udhëheqës për bashkërendimin dhe koordinimin e trupave inspektuese.
- ✓ Për rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore, gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese online, janë trajnuar dhe ritrajnuar 404 inspektorë (Autoriteti Kombëtar i Ushqimit – 62; Inspektorati Shtetëror Shëndetësor – 85; Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit – 240 dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore – 17).
- ✓ Në sistemin “*e-Inspektimi*”, akoma nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative, përveç DSHPA dhe ISHMT (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në kundërshtim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Ka mangësi në plotësimin e dokumenteve standarde të inspektimit, listë-verifikimit, procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar dhe në disa raste nuk ka shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara.
- ✓ Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore, ku marrëdhënia e punës rregullohet sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, ka bërë vlerësimin dhe testimin e aftësive profesionale për 165 inspektorë në kohë prove (AKU – 76; ISHTI – 6; ISHSH – 83).

- ✓ Janë mbështetur nga ana metodologjike njësitë administrative të qeverisjes vendore për përshtatjen e dokumenteve standarde, hartimin e listë-verifikimeve dhe implementimin e tyre në sistemin e inspektimeve “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Është mbajtur dhe përditësuar Regjistri Kombëtar i inspektorëve shtetërorë/vendorë, sipas Kreut V, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, si dhe janë shpërndarë kartat e inspektorëve.
- ✓ Është përgatitur paketa e plotë ligjore për amendimin e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore në fushën e inspektimit.
- ✓ Ka bashkëpunuar me institucione vendase dhe të huaja për shkëmbimin e praktikave më të mira, për përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e inspektimit dhe drejt përafrimit të praktikave të BE.
- ✓ Pothuajse të gjitha inspektoratet shtetërore nuk kanë realizuar rekomandimet e lëna nga raportet paraardhëse.
- ✓ Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve nuk kryejnë ende inspektime online.

## X REKOMANDIME

Inspektorati Qendror, gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese të inspektorateve shtetërore dhe trupave të tjera inspektuese, identifikoi disa problematika dhe për përmirësimin e tyre për vitin 2022, rekomandon si vijon:

- ✓ Të hartohet programi vjetor/mujor i inspektimit sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut, për të bërë të mundur parandalimin e rreziqeve që vijnë nga subjektet me rrezikshmëri të lartë, në zbatim të Urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.
- ✓ Të bëhet kategorizimi i subjekteve me risk më të lartë, me qëllim identifikimin, parandalimin ose minimizimin e riskut, sipas përcaktimeve të Urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.
- ✓ Të kryhet veprimtaria inspektuese online, nëpërmjet tabletës, në mënyrë të tillë që të ndiqet gjurmueshmëria e procesit inspektues dhe dokumentet e gjeneruara në sistem të jenë të nënshkruara nga kryeinspektori, inspektorët dhe subjekti i inspektimit.
- ✓ Të vazhdojë procesi i kryerjes së inspektimeve të përbashkëta nën koordinimin e Inspektoratit Qendror, me qëllim zvogëlimin e kostos administrative ndaj subjekteve të inspektimit.
- ✓ Për përditësimin e Regjistrit Kombëtar të inspektorëve shtetërorë/vendorë, të dërgohet informacion në kohë pranë Inspektoratit Qendror, për çdo emërim në detyrë ose për çdo lirim nga detyra të inspektorëve, sipas pikës 3 dhe 4, të Kreut V, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Të pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në modulën “gjoba”, për të gjitha inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese në zbatim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Lista e subjekteve të programuara në sistemin “*e-Inspektimi*”, të jetë e njëjtë me listën e subjekteve, sjellë me shkresë pranë Inspektoratit Qendror.
- ✓ Të vazhdojë njoftimi për subjektet e programuara, jo më vonë se 7 ditë para fillimit të procedurës së inspektimit, si dhe të ngarkojë në sistem dokumentin e njoftimit, në zbatim të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”.
- ✓ Inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese, të përditësojnë listë-verifikimet dhe dokumentet standarde në përputhje me ndryshimet ligjore.

- ✓ Të plotësohen të gjitha rubrikat dhe në mënyrë të saktë, të listë-verifikimit, procesverbalit dhe vendimit përfundimtar të inspektimit, si dhe të jepen shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara.
- ✓ Të plotësohet kohëzgjatja e inspektimit në orë, orën e fillimit dhe mbarimit, në autorizim, procesverbal inspektimi dhe vendim përfundimtar, në zbatim të pikës 2, të nenit 26, të ligjit për inspektimin.
- ✓ Të dokumentohet veprimtaria inspektuese sa më shumë të jetë e mundur me dokumente justifikuese, si foto/video etj, të cilat të ngarkohen në sistemin “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Të mbështeten me suport teknik Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, si dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të cilët akoma nuk kryejnë inspektime online.
- ✓ Të përditësohen *website* e inspektorateve shtetërore dhe të publikohen akte administrative/broshura për subjektet lidhur me procedurat e inspektimit, për të siguruar njohjen mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre.
- ✓ Të informohet sa më shumë të jetë e mundur nga ana e Inspektoratit Qendror biznesi dhe qytetarët për të gjitha aktivitetet në fushën e inspektimit, ndryshimet ligjore të propozuara dhe/ose të miratuara, për të qenë transparent dhe efektiv për detyrimet që i lindin atyre për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore.